

BASHKËJETESA ME COVID-19: TRI SHTYLLA TË RIMËKËMBJES

KORRIK 2020



BASHKËJETESA ME COVID-19: TRI SHTYLLA TË RIMËKËMBJES

KORRIK 2020

Financuar nga: Ky publikim është i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe përgatitur nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest.

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve.

Autorë:

Muhamet Mustafa, Këshilltar senior
Visar Vokri, Drejtor programor
Pëllumb Çollaku, Ekonomist senior

Design:

DROP

Origjinali është shkruar në shqip.

Publikuar nga:

RIINVEST INSTITUTE
Lidhja e Prizrenit nr. 42
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
tel: + 381 (0)38 244320 |38 223816
e-mail: riinvest@riinvestinstitute.org
www.riinvestinstitute.org

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	6
2. PERSPEKTIVA GLOBALE	8
2.1. Skenarët global	8
3. PASQYRA SHËNDETËSORE	11
3.1. pasqyra aktuale epidemike	11
4. NDIKIMET E PANDEMISË NË RRJEDHAT EKONOMIKE	17
4.1. Vlerësimet makroekonomike	17
4.2. Vlerësimet nga perspektiva e bizneseve	22
5. INTERVENIMET QEVERTARE	25
5.1. Pakoja emergjente	25
5.2. Programi i rimëkëmbjes	27
6. SITUATA POLITIKE DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE	28
7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	29
Aneks	31
ANEKS 1: PAKOJA EMERGJENTE FISKALE	31
ANEKS 2: RIMËKËMBJA EKONOMIKE PAS PANDEMISË (Programi qeveritar)	32
REFERENCAT	37

1. HYRJE

Frenimi i përhapjes së COVID-19 për t'i zvogëluar viktimat në njerëz, dëmet në ekonomi dhe marrja e masave për rimëkëmbje mbeten preokupimi themelor në planin global dhe atë nacional në secilin vend. Edhe pas gati katër muajsh ballafaqimi me këtë situatë, ende ka një pasiguri lidhur me trendët e mëtejme sa i përket infektiveve is dhe përballjes me pasojat në ekonomi dhe më gjerë në shoqëri.

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit 'Përmirësimi i politikave për t'i përballuar efektet negative të virusit COVID-19 (Corona Virus Disease, 2019)' të financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Raporti synon të rekomandojë përmirësimin e politikave për t'i zvogëluar efektet negative, me përqendrim në ekonomi, që COVID-19 ka shkaktuar në Kosovë ngjashëm me rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në rrafshin global. Gjithashtu raporti synon që t'i kontribuojë një debati domethënës dhe të paanshëm midis akterëve të interesuar lidhur me situatën aktuale shëndetësore dhe ekonomike në Kosovë. Përderisa debati në shoqëri lidhur me pasojat ekonomike e sociale të COVID-19 është intensifikuar, ai nuk duket të jetë i bazuar në hulumtime të paanshme duke qenë i ngarkuar nga këndvështrimet e veçanta sektoriale ose interesave parciais e politike. Një debat joproduktiv kemi mundur ta shohim edhe në dy seancat e fundit të Kuvendit të Kosovës dhe atë në të tri boshtet – (1) trendët e infektiveve dhe shkaqet e rritjes së tyre, (2) shtyrja e aprovimit të rishikimit të buxhetit për 2020-në dhe shtyrja e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë efekte te kompletimi i burimeve të financimit për Programin e rimëkëmbjes, dhe (3) konflikti i ashpër politik që ka ngushtuar horizontin e mendimit të arsyeshëm e të përgjegjshëm.

Në kushte të pasigurisë, si kjo me pandeminë, dizajnimi i politikave, masave dhe aksioneve për t'i përballuar rreziqet e shfrytëzuar shanset, zakonisht bazohet edhe në përvijimin e skenarëve të mundshëm të zhvillimit të situatës. Skenarët bëjnë të mundur që krijuesit dhe zbatuesit e politikave të jenë më të përgatitur dhe më fleksibil për t'u adap-

tuar ndaj situatave që kanë gjasa të ndodhin, e për të cilat situata skenarët janë të përgatitur bashkë me politikatat dhe instrumentet përkatëse për t'u përgjigjur ndaj tyre nëse ndodhin.

Ajo që duket tanimë më qartë është se të gjitha vendet duhet të përgatiten për zgjidhje që mundësojnë një lloj "bashkëjetese" me prezencën e COVID-19. Kjo nënkupton që të menaxhohet një fluks infektimesh pa pasur nevojë që të kthehen situatat e mbylljes dhe karantinimit çfarë e kishim në shumicën e vendeve, duke përfshirë edhe rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Kosovën që nga mesi i marsit e deri kah gjysma e majit. Edhe pse trendi i infektiveve pas heqjes së masave shtrënguese në shumicën e sektorëve, në Kosovë, ngjashëm me vendet e rajonit pothuajse është dy/trefishuar. Por tani thuaja askund nuk shihet si një opsion rikthimi i mbylljes ekstensive. Kjo për një arsye të thjeshtë; kosto e papërballueshme për buxhetin e këtyre vendeve dhe humbjet e papërballueshme të shumicës së bizneseve. Ndër të tjera, ky raport trajton sfidat që sjell një situatë e tillë për institucionet, bizneset dhe organizatat e tjera.

Raporti përmbyll një sërë aktiviteteve në kuadër të këtij projekti të cilit i ka paraprirë publikimi i tri punimeve (brifingjeve), njëri lidhur me situatën dhe implikimet në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i dyti lidhur me Pakon Emergjente të Qeverisë së Kosovës dhe efektet në zbatimin e saj dhe i treti lidhur me skenarët global e vendorë të rimëkëmbjes shëndetësore e ekonomike. Këtij raporti gjithashtu i ka paraprirë edhe një debat me ekspertë dhe akterë të tjerë të interesuar për t'i diskutuar rezultatet e hulumtimit. Përveç analizës së të dhënave sekondare (dokumenteve, raporteve vendore dhe ndërkombëtare, FMN, Banka Botërore, Qeveria, BQK), trajtesave dhe artikujve shkencorë e profesionalë, të dhënave statistikore, për përgatitjen e raportit Instituti Riinvest ka bërë edhe një hulumtim nëpërmjet intervistave të thelluara gjysmë të strukturuar me udhëheqësit e rreth 35 bizneseve reprezentative për sektorët relevantë ekonomik në Kosovë.

Situata akute sa i përket përhapjes së COVID-19 si në rrafshin global ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor (BP) jo vetëm që po kanos me rrezikim serioz të gjendjes shëndetësore dhe viktimat që po i merr si dëm kapital, por po përcillet edhe me pasoja në reduktimin drastik të aktiviteteve ekonomike dhe përkeqësimin e situatës sociale në rajon. Qeveritë e këtyre vendeve duke ditur fragjilitetin e sistemeve të tyre shëndetësore, ndoqën shembullin e vendeve të prekura më parë në pjesët e ndryshme të globit, duke zbatuar masa të rrepta kufizuese si distancimi fizik dhe orare të kufizuara lëvizjesh e orë policore si preventivë për t'u përballur me valën e pandemisë. Përderisa dëmet kapitale në njerëz mbeten një mister dhe do të dihen saktësisht vetëm në të ardhmen, dëmi ekonomik është veçse prezent.

COVID-19. Raporti merret më shumë me aspektet ekonomike dhe në ndërlidhje me to edhe me trendin e pandemisë dhe ngritjen e mobilizimit, organizimit dhe kapaciteteve të institucioneve të shëndetit publik. Megjithatë mbetet që të shihet si mund të tejkalohet konflikti joproduktiv politik. Primesat e luftës primitive politike kanë hyrë thellë në mënyrën e të menduarit dhe vepruarit të shumë akterëve politikë, por nga kjo fatkeqësisht nuk është imune as një pjesë e konsiderueshme e opinionit, mediave dhe shoqërisë civile. Ndoshta pikërisht ndryshimi duhet të fillojë nga këta të fundit.

Ky raport është strukturuar në 7 kapituj dhe përveç kësaj hyrjeje përfshin një shikim lidhur me perspektivën globale, pasqyrën shëndetësore, ndikimet në ekonominë e Kosovës, intervenimet në fazën emergjente dhe me programin e rimëkëmbjes, problemet e stabilitetit politik dhe institucional, përfundimet me rekomandime, ndërsa në anekse prezantohen pakoja emergjente e aprovuar nga Qeveria e kaluar dhe Programi i rimëkëmbjes ekonomike të aprovuar nga Qeveria e tashme.

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport paraqesin konstatime të Institutit Riinvest dhe jo domosdoshmërisht edhe të mbështetësit të projektit - KFOS.

2. PERSPEKTIVA GLOBALE

2.1. SKENARËT GLOBAL

Tashmë ka një konsensus të gjerë midis ekonomistëve sa i përket faktit që goditja ekonomike nga pandemia është unike dhe si e tillë mund të jetë me pasoja të papara, bile edhe më të thella sesa ato të krizës së madhe ekonomike apo siç njihet “Depresioni i madh” i viteve të 30-ta. Kjo goditje është ekzgjegjene, pra e shkaktuar nga faktorë të jashtëm, dhe rrjedhimisht nuk mund të themi që buron nga veprimet e pamatura dhe të pamenduara mirë të qeverive apo sektorit privat. Kjo në fakt e bënë këtë krizë të ndryshme edhe nga kriza e fundit financiare e viteve 2007-2008. Kriza e shkaktuar nga gjendja pandemike po manifestohet pak a shumë në të njëjtën mënyrë pothuajse në të gjitha vendet e prekura. Konsiston me një miks kompleks të goditjeve si nga ana e kërkesës (konsumit) po ashtu edhe nga ana e ofertës (bizneseve). Masat kufizuese kanë shkaktuar rënie të kërkesës agregate. Një leksion që tashmë na e ka dhënë kriza e para më shumë se një dekadë është që pa një menaxhim të kërkesës agregate, dalja nga kriza apo rimëkëmbja do të jetë shumë më e ngadalshme. Në kontekst të kërkesës problemi është i dyfishtë: (i) në njërin anë, reduktimi i aktivitetit ekonomik dhe rritja e papunësisë e largimi i përkohshëm nga puna do t'i zvogëlojë buxhetet familjare dhe do t'i detyrojë ekonomitë familjare që të zvogëlojnë edhe më tej konsumin dhe në anën tjetër bizneset kanë një aversion të investojnë në një periudhë krize kur kërkesa tashmë ka pësuar rënie.

Sa i përket ofertës, masat kufizuese të marra nga qeveritë për të parandaluar përhapjen e virusit, kanë imponuar një mori aktivitetesh që reduktojnë sasinë e produkteve dhe shërbimeve të tyre. Disa nga industritë apo aktivitetet më të prekura konsiderohen industria e argëtimit, industria e ndërtimit, industria e mikpritjes (ku hyjnë hoteleria, restorantet, e shërbime të ngjashme), apo edhe çdo aktivitet që është i varur nga turizmi. Një goditje shtesë nga aspekti i ofertës përfshirë edhe aktivitetet e

lejuara gjatë kësaj kohe vjen edhe nga mbyllja e disa qyteteve/rajoneve të caktuara, ku punëtorët e kishin të pamundur të lëviznin në baza ditore. Kjo pastaj kishte shkaktuar edhe mungesë të ofertës së atyre produkteve ku prodhimi i tyre është i varur nga një zinxhir kompleks i vlerës të cilat përfshijnë biznese që ishin jofunksionale në këtë kohë.

Skenarët e zhvillimeve lidhur me COVID-19 dhe pasojat e tyre ekonomike dhe sociale mund të përvijohen varësisht nga zhvillimet në dy boshte faktorësh kyç të ndikimit: (1) gjerësia dhe thellësia e përhapjes së COVID-19 dhe kapacitetet (teknike e humane) e vendeve të caktuara në aspektin e shëndetit publik për një përgjigje efektive në funksion të vënies nën kontroll të epidemisë dhe boshti tjetër (2) përgjigjja e qeverive qendrore dhe lokale me masat ekonomike për t'i zbutur ndikimet, konsoliduar aktivitetet ekonomike dhe për të siguruar kthimin në një gjendje normale (Mc Kinsey, prill 2020). Varësisht nga kombinimet e mundshme të këtyre faktorëve (key drivers of change), kjo organizatë e njohur konsulente paraqiti një mori skenarësh të ndryshëm.

Në mënyrë telegrafike këta skenarë duken si vijon: (1) situata kur kontrolli rapid i virusit nga institucionet e shëndetit publik është efektiv (merr 2-3 muaj), por intervenimet qeveritare me politika për konsolidimin e aktiviteteve ekonomike nuk janë efektive, kjo do të rezultonte me një përshtatje afatgjatë pas krizës, një konsolidim më të ngadalshëm; skenari tjetër dallon nga i pari për faktin se përgjigjja ndaj virusit dhe parandalimit të tij pas një efektiviteti e suksesi fillestar, vijon të jetë i pamjaftueshëm, kështu që del si domosdo që të vazhdohet më gjatë distancimi social e për pasojë rimëkëmbja ekonomike do të ngadalësohet e me këtë edhe konsolidimi i fillimit të rritjes ekonomike; skenari (3) një kombinim fatal, kur përgjigjja me politika shëndetësore është e dobët dhe kur masat e politikave

dhe aksioneve qeveritare në ekonomi paraqiten jo-efektive dhe kjo shkakton një rënie afatgjatë ekonomike, pasoja tejet negative në gjatësinë e krizës dhe rikthimit në normalitet.

Grupi tjetër i skenarëve ndërlidhet me një kombinim tjetër potencial të përgjigjes me politika shëndetësore dhe masa qeveritare në favor të aktiviteteve ekonomike, kur të dyjat janë vetëm pjesërisht efektive me këto variante të skenarëve potencialë (4) virusi i mbizotëruar – me rritje e rikthim të ngadalshëm të ekonomisë edhe kur ai është kontrolluar mirë (2-3) muaj, por pasojat do të jenë ringjallje e ngadalshme, kurse në kushtet e përgjigjeve joefektive në kontrollin e virusit ose me eskalimin e tij, pasojat negative mund të jenë afatmesme e ndoshta edhe afatgjatë, me vite.

Duke marrë parasysh rrjedhat e përgjithshme, McKinsey si më të mundshme (palusible) ka zgjedhur dy prej skenarëve: Skenari (A) i cili është një kombinim i një situatë ku virusi zgjerohet deri midis kuartalit të dytë dhe pastaj fillon reduktimi tij si përgjigje e masave në planin e shëndetit publik, por masat në planin ekonomik kanë qenë vetëm pjesërisht (apo mesatarisht) efektive¹.

Skenari (B): virusi rikthehet pas një rënie sezonale (ngase masat në aspektin shëndetësor kanë qenë vetëm pjesërisht efektive, dhe masat në planin ekonomik po ashtu të ngjashme me skenarin paraprak (po ashtu pjesërisht efektive). Sipas këtij skenari kjo situatë do të prodhonte një rikthim shumë më të ngadalshëm të normalitetit dhe pasoja në rënie më të madhe të GDP-së². Sipas këtij skenari shumicës së vendeve do t'iu duhen së paku dy vjet për kthim në normalitet dhe situata në ekonomi do të përcillet me falimentime të bizneseve dhe rritje të lartë të papunësisë të papara-parë që nga krizat ekonomike të viteve 1930.

1 Sipas këtij skenari kjo situatë do të prodhonte një rikthim shumë më të ngadalshëm të normalitetit, dhe pasoja në rënie më të madhe të GDP-së. Rënie në Kinë në krahasim me kuartalin paraprak -3.9%, në baza vjetore -2%, kthimi në normalitet Q2 të 2021; në rastin e ShBA-së situata do të zhvillohej ashtu që rënia në krahasim me kuartalin para COVID-19 do të ishte 10.6%, në baza vjetore -2.4%, e kthimi në normalitet në Q2 të 2021; Në BE rënia në krahasim me kuartalin para COVID-19 - 12.2%, në baza vjetore 9.7%, e kthimi në normalitet është Q3 2023 (Mc Kinsey, prill 2020)

3 Rënie në Kinë në krahasim me kuartalin paraprak -3.9%, në baza vjetore -2%, kthimi në normalitet Q2 të 2021; në rastin e ShBA-së situata do të zhvillohej ashtu që rënia në krahasim me kuartalin para COVID-19 do të ishte 10.6%, në baza vjetore -2.4%, e kthimi në normalitet në Q2 të 2021; Në BE rënia në krahasim me kuartalin para COVID-19 12.2%, në baza vjetore 9.7%, e kthimi në normalitet është Q3 2023; (Mc Kinsey, prill 2020)

4 A Crisis Like No Other, An Uncertain Recovery: World Economic Outlook, IMF (June 2020)

Duke qenë se situata është komplekse si përgjigje ndaj saj me rëndësi esenciale është të sigurohet një bashkërenditje efektive e masave në planin e shëndetit publik dhe të masave mbështetëse biznesore për ekonomi, një pune ekipore dhe të bashkërenditur. Kjo nënkupton edhe inkuadrimin e sektorit privat në këto aktivitete si një parakusht për të siguruar një rikthim më të shpejtë në gjendjen e para krizës.

Fondi Monetar Ndërkombëtar në projeksionet më të reja e paraqet situatën më serioze sesa parashihte në prill dhe korrigjon projeksionet e tij, të cilat duken si një gjendje miksi midis këtyre dy skenarëve (a) dhe (b), duke projektuar një rënie të GDP-së në nivel global 4.9% (qershor 2020), në vend të 1.9% (prill 2020)³. Turrja e GDP-së dhe e të ardhurave për një banor projektohet për 95% të vendeve të botës. Disa shenja të përmirësimit shihen por pasiguria është e madhe në kushtet kur 75% e vende të botës janë hapur pas masave strikte të karantinimit. (IMF, June 2020).

Ekonomistë të shquar po tërheqin vërejtjen se çmimi i pandemisë (tall) do të jetë shkatërrues dhe apelojnë për një plan imediat shpëtimi. "COVID-19 është një problem global që kërkon edhe qasje globale". (Stiglitz, Projct Syndicate, April 2020). Problem i veçantë janë ekonomitë në zhvillim ngase ato kanë zgjedhje më të pakta dhe më të vështira. Andaj Stiglitz tërheq vërejtjen për rrezikun që të ndodhë përkeqësimi i varfërisë, deri në një situatë kur një popull ka brengë ushqimin. Kjo është një situatë kur një ulje e vogël e të ardhurave, mund të ndikojë në rritjen e varfërisë. Ky është rreziku i krijimit të situatës kur kreditorët kanë më shumë borxhe sesa që mund të paguajnë. Ristrukturimi i borxheve konsiderohet i domosdoshëm në periudhën postpandemike. Këtë problem e spikatin edhe

ekspertët e 'think tankut' të njohur Bruegel⁴ duke potencuar se COVID-19 është sfida më e madhe e paraqitur për ekonominë në zhvillim në historinë më të re. Varësia ekscesive e këtyre ekonomive emergjente nga financimi i jashtëm në kombinim me një reduktim radikal të qasjes në burime financimi sidomos nga turizmi, eksporti dhe remitencat. Kjo përkeqësohet edhe më shumë nga rënia e çmimeve eksportuese të disa mallrave karakteristike për eksportin e tyre, siç janë metalet dhe burimet e tjera primare. E kësaj i shtohet fakti se te këto vende masat e politikave fiskale kanë një efekt më të vogël në krahasim me ekonominë e zhvilluara.

Konsiderohet se për t'i zbutur pasojat dhe për të siguruar një rikthim në normalitet sa më të shpejtë është me shumë rëndësi një bashkërenditje dhe gërshetim i konsolidimit të dy boshteve kyçe: shëndetit publik dhe mbështetjes së aktiviteteve ekonomike. Në fushën e shëndetit publik duhet të rritet gatishmëria e institucioneve të shëndetit publik për ta kontrolluar përhapjen e virusit (kapacitetit të vendosjes, testimit, mbrojtës), të rritet aftësia për testim rapid dhe aftësia e identifikimit, përcjelljes dhe mbikëqyrjes së kontakteve (baza e të dhënave). Në planin ekonomik praktikisht duhet rritur efektivitetin e masave që janë marrë edhe këtu dhe gjithandej në

botë: subvencionet e huave, përkatësisht kredive; shtyrja e pagesave, taksave, kontributeve, kredive, taksave dhe intervenimet me grante e subvencione. Rivitalizimi i aktiviteteve ekonomike duhet të bëhet sipas prioriteteve të caktuara, të cilat do të duhej të nxirreshin varësisht nga relevanca e sektorit të caktuar për nga kontributi i tij në GDP, punësime, etj. Sipas kësaj prioritet duhet të merrnin sektorët që kanë një peshë më të madhe në ekonominë e vendit dhe që paraqesin një rrezikshmëri më të vogël, si p.sh. bujqësia, industria, ndërtimtaria, logjistika. Këta duhet të jenë qarku i parë i aktivizimit dhe i mbrojtjes nga mbyllja e serishme, në qarkun e dytë do të ishin patundshmëritë, shërbimet profesionale dhe të ngjashme dhe në qarkun e tretë (pesha më e ulët, por rreziku i lartë): akomodimi dhe ushqimi, argëtimet, udhëtimi.

Sa i përket boshtit shëndetësor është provuar se vendet me teste agresive e gjithëpërfshirëse kanë dalë më të suksesshme. Shembulli i Koresë së Jugut konsiderohet si një storie suksesi dhe është bazuar pikërisht në një testim agresiv, në evidencimin dhe përcjelljen e kontakteve të të infektuarve dhe karantinimin e obligueshëm të zonave të kufizuara.

4 Alicia García-Herrero and Elina Ribakova (maj 2020), Bruegel

3. PASQYRA SHËNDETËSORE

3.1 PASQYRA AKTUALE EPIDEMIKE

Menjëherë pas paraqitjes së rasteve të para Qeveria e Kosovës tregoi një mobilitet dhe përkushtim për t'u përballur me virusin COVID-19. Nga gjysma e marsit dhe deri në fund të majit zbatoi një strategji rigorozë frenimi kryesisht nëpërmjet kontrollit të rreptë të lëvizjes, karantinimit dhe mbylljes së aktiviteteve ekonomike e sociale. Kjo pasoi me një hapje të kontrolluar nga 18 maji, dhe me një hapje pothuajse totale, ndoshta tepër ekstensive, në fund të majit e në fillim të qershorit, duke përfshirë edhe kufijtë tokësorë dhe lejimin e ngjarjeve dhe manifestimeve që përfshinin me mijëra persona.

Kësisoj Kosova implementoi politikën e sheshimit të lakores së dinamikës së infektiveve me synimin e ngadalësimit të përhapjes së virusit. Vetëm sheshimi i lakores nuk eliminon gjasat e marrjes së sëmundjes, andaj nuk është e qartë nëse Kosova do të ketë më pak raste në përgjithësi, por përmes saj blihet kohë deri në zhvillimin e vaksinës duke parandaluar mbingarkesën në sistemin e kujdesit

shëndetësor dhe ulur numrin e vdekjeve (mosn-garkesa u mundëson qendrave mjekësore që t'u ofrojnë më me komoditet shërbime pacientëve të prekur - pajisje në mungesë si ventilator, respiratorë, etj.). Duke ditur brishtësinë e sistemit shëndetësor Kosova reagoi me shpejtësi në vendosjen e masave drastike në kufizimin e lëvizjes, distancës sociale dhe aktiviteteve ekonomike.

Megjithatë rritja e rasteve të infektiveve së fundmi pas heqjes së masave të kufizimit ka sfiduar seriozisht kapacitetet e institucioneve të sistemit shëndetësor publik. Investimet në këtë sektor (shih Tabelën 3) kanë qenë të neglizhuara gjatë gjithë periudhës së pasluftës. Por duket se as kjo periudhë katërmujore nuk u shfrytëzua për një intervenim domethënës. Në fakt ky sistem rriti vetëm në baza minore kapacitetet e tij gjatë karantinimit masiv që Kosova pati muajt e parë, duke lënë trajektoren e infektiveve të ecë drejt një të ardhme shumë stresuese për popullatën dhe institucionet.

TABELA 1. TREGUESIT E PANDEMISË COVID-19 NË KOSOVË DHE NË RAJON NË RAPORT ME POPULLSINË, NË PËRQINDJE (%).


Shteti	Numri i testimeve/ Nr. i popullsisë	Rastet aktive/ Nr. i popullsisë	Nr. i vdekjeve/ Nr. i infektiveve	Nr. i infektiveve/ Nr. i testimeve
BeH	3.18	0.09	3.56	5.62
Kosova	1.43	0.11	2.10	15.52
Mali i Zi	2.42	0.10	1.77	6.31
Maqedonia V.	3.42	0.17	4.85	10.40
Serbia	6.65	0.05	2.00	3.68
Shqipëria	1.06	0.04	2.67	10.13

BURIMI: TË DHËNAT PËR RASTET COVID-19 JANË NGA INSTITUTET KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË VENDEVE PËRKATËSE, WORLDOMETER DHE HOROSHO-TAM; DERI MË 8 KORRIK, 2020; TË DHËNAT E POPULLSISË NGA BANKA BOTËRORE, EUROSTAT DHE ZYRAT KOMBËTARE TË STATISTIKAVE. KALKULIMET E AUTORIT

Tabela 1 ilustron situatën aktuale në lidhje me rastet aktive, të vdekjeve, testimet dhe numrin e popullsisë në Kosovë dhe rajon (8 korrik, 2020). Në terma nominalë (absolut) Kosova renditet në vendin e katërt në rajon për nga numri i rasteve aktive me COVID-19, derisa Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi kanë numrin më të madh, respektivisht, më të vogël të rasteve aktive.

Fillimisht u duk se Kosova dhe vendet e saj fqinje kaluan lehtë pikun e përhapjes së virusit. Por, një pasqyrë më të qartë tregon Figura 1 (më poshtë), e cila jep numrin e të të infektuarve në raport me popullsinë. Në këto lakore, të gjitha shtetet kanë trend rritës të infektimit ku shqetësuese është gjendja e Kosovës, e cila pas 16 qershorit shtoi dukshëm dinamikën e rritjes së infektimit në krahasim me të gjitha vendet e rajonit duke përjashtuar Maqedoninë Veriore.

FIGURA 1. NUMRI I INFECTIMEVE NË RAPORT ME NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË NË KOSOVË DHE RAJON, I SHPREHUR NË PËRQINDJE, PERIUDHA 13 MARS – 8 KORRIK, 2020.



BURIMI: INSTITUTET KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË PUBLIKE, 2020. KALKULIMET E AUTORIT.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë, treguesit lidhur me përhapjen dhe pasojat e COVID-19 duhet të shikohen në raport me numrin e popullsisë. Në Tabelën 2 shihet qartë që situata me Kosovën është shqetësuese pasi qëndron në pozitën e dytë në rajon me një koeficient prej 0.11% të popullsisë

me raste aktive me COVID-19. Argument tjetër është probabiliteti i lartë i infektimit në numrin e përgjithshëm të testeve, vendi i parë në rajon me 15.52% të të testuarve që dalin pozitiv me COVID-19.

TABELA 2. TREGUESIT E PANDEMISË COVID-19 NË KOSOVË DHE NË RAJON NË PËRQINDJE NË RAPORT ME POPULLSINË.

Shteti	Numri i testeve/ Nr. i popullsisë	Rastet aktive/ Nr. i popullsisë	Nr. i vdekjeve/ Nr. i infektimit	Nr. i infektimit/ Nr. i testeve
BeH	3.18%	0.09%	3.56%	5.62%
Kosova	1.43%	0.11%	2.10%	15.52%
Mali i Zi	2.42%	0.10%	1.77%	6.31%
Maqedonia V.	3.42%	0.17%	4.85%	10.40%
Serbia	6.65%	0.05%	2.00%	3.68%
Shqipëria	1.06%	0.04%	2.67%	10.13%

BURIMI: TË DHËNAT PËR RASTET COVID-19 JANË NGA INSTITUTET KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË VENDEVE PËRKATËSE, WORLDOMETER DHE HOROSHO-TAM; DERI MË 8 KORRIK, 2020; TË DHËNAT E POPULLSISË NGA BANKA BOTËRORE, EUROSTAT DHE ZYRAT KOMBËTARE TË STATISTIKAVE. KALKULIMET E AUTORIT.

Tabela zbulon që Kosova qëndron e parafundit për nga numri i testeve në raport me popullsinë (1.43%), derisa Serbia ka numrin më të madh të testeve të popullsisë (6.65%), me Shqipërinë e renditur si e fundit me vetëm 1.06% të qytetarëve të testuar për COVID-19.

Numrin më të madh të vdekjeve nga gjithsej infektimet rezulton ta ketë BeH (6.07%), e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 5.65%. Shkallën më të ultë të vdekjeve në rajon e mban Serbia me 2.14%, Kosova ka një përqindje prej 2.10% të të infektuarve që përfundojnë me vdekje (e katërta në rajon), derisa Maqedonia e Veriut prin renditjen me 4.85% të rasteve të infektuara që përfundojnë me fatalitet.

Në një rast si ky, gjendja e sistemit shëndetësor dhe aftësia e tij që të përballojë një krizë të shëndetit publik është kryesorja. Në fakt, dobësimi i sistemit shëndetësor dhe eksodi masiv i stafit mjekësor nga Kosova drejt BE-së kanë zbehur mundësitë e një suksesi të shpejtë. Zaten kjo mbase është dhe arsyeja kryesore pse Kosova aplikoi një model me stimulim fiskal të ulët kombinuar me distancë shoqërore të ashpër. Meqë kualiteti i sistemit shëndetësor të një vendi varet nga pasuria, atëherë s'do mend që shtetet më të pasura të jenë më të suksesshme në tejkalimin më të shpejtë të situatës, ku Kosova po gëc.

TABELA 3. SHPENZIMET QEVERTARE TË KOSOVËS NË SHËNDETËSI 2018 – 2020 (MIL. EURO)

	2018	2019	2020 (rishikimi)
Shpenzimet qeveritare në shëndetësi	197	226	237
Produkti Vendor Bruto	6,641	7,123	6,961
Shpenzimet/ PVB	2.9%	3.1	3.4

BURIMI: DREJTORIA E BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE

Tabela 3 më sipër lidhur me shpenzimet qeveritare në shëndetësi, duke përfshirë gjithë intervenimet (primar, sekondar, terciar e administrativ), tregon për një nivel tepër të ulët të financimit të shëndetësisë nga burimet buxhetore. Ndonëse me një tendencë përmirësimi (nga 2.9 të GDP-së më 2018, në 3.4 me % buxhetin e rishikuar) gjithnjë mbetet shumë prapa nevojave e mund të thuhet edhe domosdoshmërisë për ta përmirësuar gjendjen kritike në këtë sektor. Deklarimet e thuaja të gjitha kabineteve qeveritare për t'i dhënë një prioritet këtij sektori kanë mbetur vetëm në një nivel verbal. Kjo shihet edhe më mirë në tabelën e mëposhtme nëse

krahasohemi me vendet e rajonit e të mos flasim për standardet evropiane. Kosova shpenzon rreth 3 herë më pak në këtë sektor krahasuar me Bosnjë e Hercegovinën dhe Serbinë, gati dy herë e gjysmë më pak sesa Mali dhe dyfish më pak sesa Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut krahasuar me fuqinë ekonomike përkatësisht GDP-në. Përmirësimet simbolike nuk janë të mjaftueshme në këtë situatë. Ndonëse shihet një hap pozitiv me buxhetin e rishikuar kjo duket krejtësisht e pamjaftueshme për të bërë një përmirësim të ndjeshëm të gjendjes në gjithë nivelet e kujdesit shëndetësor.

TABELA 4. INDIKATORË TË SHËNDETIT PUBLIK NË KOSOVË DHE RAJON, NË PËRQINDJE.

Viti	Popullata mbi 65 vjeç, % e totalit	Shpenzimet qeveritare në shëndetësi, % e BPV*	Shpenzimet qeveritare në shëndetësi, US\$ per capita*
	2020 (est)	2017	2017
BeH	17.9	9.2	443.8
Kosova	6.3	3.1	126.17
Mali i Zi	15.8	7.6	531.7
Maqedonia V.	14.5	6.3	327.8
Serbia	19.1	9.1	494.4
Shqipëria	14.7	6.7	271.5

BURIMI: TË DHËNAT PËR POPULLSINË MBI 65 VJEÇ JANË VLERËSIMË PËR VITIN 2020 NGA BANKA BOTËRORE DHE EUROSTAT, PËR KOSOVËN NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS, VITI 2018. TË DHËNAT MBI SHPENZIMET QEVERTARE NË SHËNDETËSI NGA OBSH, BANKA BOTËRORE, WIIW DHE MF TË KOSOVËS; *KOSOVA 2019.

Megjënese COVID-19 atakon më shumë të moshuarit me një shkallë më të lartë të vdekjeve (rasti me Italinë dhe vendet e tjera), shtetet e rajonit me popullsi më të re pritet të dalin më pak të dëmtuara në jetë njerëzish. Nisur nga kjo, Kosova qëndron në një situatë më të favorshme me vetëm 6.3% të popullsisë mbi 65 vjeç kundrejt Serbisë e cila renditet 'më e moshuara e rajonit' me 19.1%. Edhe në shpenzimet në shëndetësi për kokë banori më së keqi qëndron Kosova me një vlerë dukshëm më të vogël sesa shtetet e tjera fqinje.

Më 1 qershor 2020, u kalua në fazën III të heqjes së masave shtrënguese që nënkupton aktivizimin e sektorit të akomodimit - hotelet, restoran-

tet, kafenetë dhe çerdhet, dhe hapjen e kufijve tokësorë. Edhe pse kjo hapje ishte e mirëseardhur për ekonominë, trajektorja e infektiveve të fundit tregon për një situatë të rënduar me COVID-19. Megjithatë po shihet se hapja u bë pa ndonjë rritje të kapaciteteve të institucioneve shëndetësore për testime, përcjellje dhe krijim të bazës së të dhënave për kontaktet dhe mbikëqyrjen e tyre rigorozë paralel me hapjen e ekonomisë. Kjo praktikë duhej të ishte esenciale pasi hapja e pakujdesshme solli rritjen e numrit të rasteve dhe për pasojë rrezikun e kthimit të trendëve në kahun e padëshirueshëm. Situata ka imponuar një aktivizimin parcial të kufizimeve (rikthim i orës policore nga 21:00-5:00) me efekte negative në sektorin e akomodimit kryesisht.

TABELA 5. KOSOVA/BALLKANI PERËNDIMOR (%)⁵

Pjesëmarrja në popullsi	10.4
Pjesëmarrja në numrin e të infektuarve	9,1
Pjesëmarrja në raste aktive	13.7
Pjesëmarrja në numrin e të testuarve	3.9
Pjesëmarrja në numrin e të vdekurve	1.3

Të dhënat e mësipërme na thonë se numri i të infektuarve është afërsisht proporcional (diçka më i vogël) në krahasim me popullsinë, por për rreth 33% më i lartë sa i përket rasteve aktive; numri i të testuarve 2.5 herë më i vogël në krahasim me rajonin, kurse numri i viktimave më shumë se 7 herë më i vogël sesa rajoni. Te numri i viktimave ndikon sigurisht edhe struktura moshore e popullsisë. Krahasimi me vendet e caktuara të rajonit na nxjerr më së keqi në rastin e testimeve në raport me popullsinë, në vendin e tretë, në kuptim negativ (pas Maqedonisë e Shqipërisë) lidhur me rastet aktive në krahasim me popullsinë, në situatën më të volitshme sa i përket rastit të vdekjeve nga virusi (1.7% e të infektuarve të evidentuar) dhe në situatën më të pafavorshme lidhur me % e të infektuarve në numrin e të testuarve (11.8%), para Maqedonisë (10.7%) dhe Shqipërisë (10.4%). Përfundimi kryesor nga këto të dhëna është se kishim numër proporcionalisht të vogël të të testuarve dhe % e lartë e të infektuarve nga të testuarit. Kjo do të thotë se testimi ka qenë restriktiv dhe është bërë te personat që kanë shfaqur simptome më serioze të infektimit. Andaj

duket se problemi themelor i Kosovës kanë qenë kapacitetet e limituara për testim. Dhe kjo padyshim se ka tagrin e vet në rritjen e numrit të të infektuarve gjatë periudhave të mëvonshme e që shihet sidomos me situatën gjatë qershorit e korrikut. Prej të dhënave nga burimet e përmendura mësojmë, po ashtu, se frekuenca mesatare e testimeve ditore ka ardhur duke u rritur dhe atë nga 190 raste në periudhën 13 mars -31 maj, në 289 raste testimesh mesatare ditore në periudhën 1- 29 qershor. Ndonëse në qershor kemi një dinamikë të rritur testimesh për 52%, duket sheshit se kjo nuk është e mjaftueshme dhe se ky është problemi esencial në ballafaqimin me COVID-19. Ndonëse ky problem po adresohet kohëve të fundit nëpërmjet decentralizimit të testimit në qendra rajonale dhe certifikimit edhe të operatorëve privatë, blerjes së më shumë testeve dhe aparaturave përkatëse është çështje se, sa do të marrë kohë e tërë kjo? Tash është një luftë ditore me kohën. Nga perspektiva e tashme shihet se këto masa janë të vonuara dhe se duhej të merreshin qysh në prill së paku.

⁵ Llogaritur nga Instituti Riinvest duke u bazuar në të dhënat e Wordometer, Horosho-tam (për numrin e testimeve), etj., gjendja më 29 qershor 2020.

4. NDIKIMET E PANDEMISË NË RRJEDHAT EKONOMIKE

4.1 VLERËSIMET MAKROEKONOMIKE

Ndonëse ky punim ka një përqendrim tek aspektet ekonomike, u ndalëm te situata epidemike pasi që boshti i politikave shëndetësore publike dhe kapaciteteve të institucioneve publike shëndetësore (humane e të pajisjeve teknike dhe financiare) është i pandashëm me boshtin e politikave, programeve ekonomike dhe angazhimeve për rimëkëmbje. Siç pamë më lart, nga kombinimi i këtyre dy boshteve mund të përvijohen edhe skenarët e zhvillimit të situatës më tutje.

Edhe në vlerësimet më të reja të FMN-së, për dalim nga korrjigjimet që Fondi ka bërë në trendet në rrafshin global, sa i përket Kosovës ende mbetet në projeksionet për një tkurrje të GDP-së 2020 në krahasim me 2019 për rreth 5 %, e që është në përputhje me vlerësimet tona që nga fundi i marsit 2020⁶. FMN-ja evidenton edhe rreziqe të caktuara të cilat këtë tkurrje mund ta thellojnë edhe më shumë duke provokuar një kontraktim edhe më të madh të eksportit, remitencave dhe të ardhurave në buxhet. Ky rrezik edhe sipas FMN-së bëhet më evident edhe për shkak të fluiditetit të gjendjes politike, e cila kohëve të fundit është shoqëruar edhe me rreziqe shtesë. Gjendja e përshkruar më lart në boshtin shëndetësor i bën këto rreziqe edhe më serioze⁷.

Me propozimet për rishikimin e buxhetit 2020 dhe analizat përcjellëse makroekonomike që e shoqërojnë atë, del të jetë një pasqyrë më optimiste⁸. Është projektuar një rënie e produktit vendor bruto vetëm për 3%. Rishikimi i buxhetit ka imponuar ndryshime në shumë parametra. Të ardhurat buxhetore janë zvogëluar për 11,5% (nga 2 miliardë në afro 1,8 mil-

iard euro), në ndërkohë që shpenzimet e buxhetit janë rritur për 11 % (nga 2,3 në 2.6 miliardë euro). Kjo ka ndikuar për rritje të deficitit në bilancin primar të buxhetit nga rreth 337 milionë euro (sa ishte planifikuar me buxhetin e aprovuar në mars 2020), në një deficit primar prej 831 milionë eurosh. Ky deficit synohet të mbulohet nga financimi i jashtëm shtesë prej 321 milionë eurosh (kryesisht me huat e FMN-së, BB-së dhe BE-së) dhe financimin e brendshëm 367 milionë euro (kryesisht emetimi i letrave me vlerë dhe fondet nga AKP-ja) si dhe zvogëlimi i stokut të bilancit bankar për 143 milionë. E tërë kjo duhet t'i mbulojë kërkesat e paraqitura për financim të Programit të rimëkëmbjes 385 milionë, rritjes e shpenzimeve kapitale për 63 milionë euro si dhe të subvencioneve e transfereve 18 milionë euro. Me një fjalë ky rishikim i buxhetit i nxitur me situatën rreth COVID-19 ka rritur intervenimet qeveritare për 462 milionë euro.

Projeksionet lidhur me rritjen ekonomike në vitin 2020 që e shoqërojnë rishikimin e buxhetit mbesin të testohen në muajt në vijim, por nëse i referohemi situatës aktuale me infektimet dhe pastaj edhe vonesave me aprovimin e rishikimit dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe bërjes së tyre operacionale e të zbatueshme duken optimiste. Rreziqet gjithnjë mbeten rënia më e madhe e konsumit e investimeve private (Shih deklaratimet e bizneseve në pikën 4.2 të këtij raporti), është evidente se rënia e kërkesës agregate do të përcillet me rënie të investimeve sidomos në industrinë përpunuese, sektorin e ndërtimit dhe sidomos në çdo aktivitet tjetër ekonomik që është i lidhur me turizmin⁹.

6 Shih Telegrafi, 31 mars 2020 (Intervistë M. Mustafa)

7 IMFKOSEA2020001.pdf

8 Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

9 Shih intervistën e Riinvest me udhëheqës të bizneseve

**TABELA 6. PARASHIKIMET PËR INDIKATORËT THEMELORË MAKROEKONOMIKË 2020
(NORMAT E RRRITJES/ ZVOGËLIMIT NË % NË KRAHASIM ME VITIN PARAPRAK**

	2019 (vlerësim)	2020 (rishikimi)
Produkti Vendor Bruto (GDP)	4	-3
Konsumi	2,5	-1.2
Investimet	3.7	-14.5
Eksporti	6.3	-10.4
Importi	2.3	-9.6
Indeksi i çmimeve të konsumit	2.7	1
Bilanci i llog. rrjedhëse	-5.8	-7.8
Bilanci tregtar	-39.9	-37.4
Norma e papunësisë	25.7	

BURIMI: DREJTORIA E BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE

Rënia e aktivitetit ekonomik dhe rrjedhimisht e investimeve pashmangshmërisht do të ketë implikime edhe në punësim. Një numër i madh i vendeve të punës do të shfrytëzohen vetëm pjesërisht me një përmirësim me lehtësimin e masave dhe hapjen e ekonomisë, mirëpo një numër tjetër ka rrezik të humbjen në mënyrë permanente. Si pasojë e rënies së kërkesës do të ulet edhe importi dhe rrjedhimisht të hyrat tatimore të vjela në importe (TVSH dhe tarifa doganore), si burime tejet të rëndësishme për mbushjen e buxhetit të Kosovës.

Investitorët e jashtëm do ndikohen shumë me aversionin ndaj rrezikut të shtuar. Kosova është në një pozitë më 'të lakmueshme', krahasuar me fqinjët e saj, sa i përket ngarkesës me borxh publik dhe kjo mund t'i reduktojë pengesat e financimit nga jashtë (shih Tabelën 6). Gjatë kohës së krizës Kosova pritet të rrisë llogarinë e saj të borxheve e cila do mbetet e lartë për një kohë, borxh për të cilin

do ta bartin edhe gjeneratat e ardhshme. Kanalet e vërteta makroekonomike të ndikuara gjatë kësaj krize duket e vështirë të maten në përgjithësi. Sidoqoftë, në këtë publikim të shkurtër ne po renditim tri më kryesoret: hapjen tregtare, varësinë nga turizmi, sidomos "turizmi i diasporës" dhe neto bilancin në energji. Kosova karakterizohet si ekonomi e vogël dhe e hapur, kryesisht e varur nga tregtia. Andaj, gjëja e parë që shkon ndërmend është fakti që ajo goditet rëndë nga rënia dhe çrregullimi në tregtinë botërore (kemi në mendje mallrat dhe shërbimet jo-esenciale). Edhe pse e vërtetë, ajo mund të jetë përcaktuese vetëm në një të ardhme afatmesme, pasi që problem kryesor aktual është rënia e kërkesës agregate vendore si rezultat i pasigurisë dhe kufizimit të jetës normale ekonomike. Megjithëse me stimulimin e madh fiskal që Gjermania dhe ekonomitë e zhvilluara pritet t'i ofrojnë ekonomisë së tyre, vendet e lidhura me to, pritet të përfitojnë nga këto masa në formë të efekteve

pozitive shpërndarëse (spill-overs) duke rritur potencialisht eksportet, remitencat, e të ngjashme.

Sektori i turizmit është dërrmuar nga kriza e shkaktuar nga COVID-19. Nëse situata vazhdon me kufizime të lëvizjes si intra- dhe ndërshtetërore, gjë që ende nuk është asgjë e sigurt për hapje, horizonti nuk jep shpresa pozitive për turizmin. Si sektor në rritje në gjithë rajonin turizmi pritet të ketë 'spill-overs' në tërë rajonin. Për Kosovën situata është posaçërisht delikate, pasi që pjesa dërrmuese e asaj që llogaritet turizëm, është turizëm i diasporës – emigrantëve që kthehen në vendlindje gjatë

pushimeve, e që sipas disa vlerësimeve të bëra nga zyra statistikore e BQK-së, rreth 400¹⁰ milionë euro (5.7% e BPV-së), e që nuk raportohet nga ASK-ja (e cila raporton vetëm grupimin 'Hotele dhe restorante'), por vetëm si një matje sekondare përmes anketave interne që bën BQK-ja çdo vit. Nëse kufizimet për udhëtimet ndërshtetërore nuk hiqen, atëherë Kosova pritet të goditet rëndë nga masa të tilla, gjë që veç ka filluar të ndjehet pasi Gjermania, Zvicra, dhe Austria kanë vendosur restriksionet e reja për imigrantët që udhëtojnë drejt vendeve të tyre të origjinës, përfshi dhe emigrantët kosovarë.

TABELA 7. INDIKATORËT KRYESORË MAKROEKONOMIKË, NË PËRQINDJE.

Shtetet	Hapja tregtare, % e BPV (2019)	Turizmi*, % e BPV (2016)	Neto bilanci i energjisë, % e BPV (2019)
BeH	99,2	9,9	-5,0
Kosova	82,0	1,2	-6,4
Mali i Zi	109,6	25,1	-4,1
Maqedonia V.	133,8	6,8	-6,4
Serbia	110,1	6,7	-4,8
Shqipëria	77,1	26,3	-1,4

BURIMI: BURIMI: BANKA BOTËRORE DHE WIIW.

SHËNIM: * KALKULIMET PËR TURIZMIN NË KOSOVË JANË BËRË NGA TË DHËNAT E DISPONUESHME NË AGJENCINË E STATISTIKAVE TË KOSOVËS, VETËM PËR KATEGORINË 'HOTELE DHE RESTORANTE', VITI 2018; KALKULIMET E AUTORIT.

10 Deklaratë e zyrtarit të BQK-së, z. Bedri Zymeri, në debatin e organizuar online nga Instituti Riinvest, në qershor 2020 me temë Implikimet ekonomike dhe sociale të COVID-19 në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor.

Tabela 7 tregon, po ashtu, varësinë e madhe të Kosovës në energji. Meqë eksperiencën na mëson se humbjet e eksportuesve jo medoemos përkthehen në fitime të importuesve, çmimet e energjisë nuk do thotë që do bien, andaj pjesëmarrja e madhe e importit të Kosovës në energji në raport me BPV – neto bilanc negativ (më i madhi në rajon me -6.4%), mund ta përkeqësojë gjendjen.

Implikime shtesë mund të ketë edhe nga rënia e efektit pozitiv të remitencave (dërgesave të parave) dhe shpenzimeve të tyre në Kosovë sidomos gjatë verës. Ky ishte një burim me peshë dhe i qëndrueshëm i financimit të ekonomive familjare në Kosovë. Hipoteza e zbutjes apo lehtësimit të gjendjes së pranuesve të remitencave si motiv parësor i dërgesave, na mëson që remitencat kanë karakter kundër ciklik sa i përket të ardhurave në ekonomitë ku remitencat luajnë rol të rëndë-

sishëm në mirëqenien e ekonomive familjare. Kjo që një karakteristikë edhe për rrjedhën e remitencave gjatë krizës së ashpër financiare në BE në periudhën 2007-2008. Kontributi i diasporës në ekonominë e Kosovës nuk mund të reduktohet vetëm në remitenca; ai është shumë më i madh sesa kaq. Paratë e shpenzuara dhe investimet e bëra gjatë pushimeve në Kosovë, dhe investimet e tyre, sidomos në patundshmëri, vlerësohet të jenë afërsisht sa niveli i remitencave.

Tabela (8) konfirmon hipotezën se me gjasë nuk do të goditemi me rënie të remitencave. Në pesë muajt e parë të këtij viti kemi pasur një rritje të fluksit të remitencave me 5% në krahasim me vitin paraprak. Madje, muaji maj shënoi rritje prej 28% apo mbi 22 milionë euro më shumë krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2019.

TABELA 8. RRJEDHA E DËRGESAVE - TË REMITENCAVE NË KOSOVË 2019-2020, NË EURO

Muaji	2019	2020	Diferenca	Ndryshimi në %
Janar	56,365,301	62,285,775	5,920,474	11
Shkurt	56,626,462	63,333,839	6,707,377	12
Mars	71,667,061	61,712,490	-9,954,572	-14
Prill	68,819,500	60,277,594	-8,541,906	-12
Maj	78,385,367	100,717,461	22,332,094	28
Total	331,863,692	348,327,159	€16,463,466	5

BURIMI: BQK, 2020

Megjithatë komponenti tjetër, i ashtuquajtur “Turizëm i diasporës” do të goditet shumë më tepër. Tanimë jemi në gjysmën e korrikut. Gjendja me infektimet, testimet dhe restriktionet e udhëtimit nga disa vende evropiane do ta zvogëlojnë këtë komponentë me gjasë ndjeshëm.

Rimëkëmbja ekonomike e Kosovës varet nga shumë faktorë: shkalla e ardhshme e përhapjes së virusit, kujdesi i qytetarëve në respektimin e udhëzimeve për shëndetin publik, fuqizimi i sistemeve shëndetësore dhe zbatimi efektiv i Programit të rimëkëmbjes të inkuadruar në pjesën më të madhe edhe brenda rishikimit të buxhetit. Duke pasur parasysh këta faktorë, konsiderojmë që trajektorja e rimëkëmbjes mund të kalojë në dy skenarë kryesorë, varësisht edhe nga aftësia e Qeverisë për mbështetje financiare të ekonomisë. Në skenarin e parë jemi dëshmitarë të një situatë ku jeta ekonomike ka qenë e kufizuar ashpër për 3 muaj. Në këtë opsion, ne supozojmë që izolime parciais mund të ndodhin edhe pas lehtësimit të kufizimeve, varësisht nga trendi i infektiveve, derisa të kemi një vaksinë brenda 12-18 muajve të ardhshëm. Në këto kushte, rënia e PVB-së në terma realë, që sipas parashikimeve të ndryshme në rajon silltet të jetë rreth 3-5 për qind (Banka Botërore, 2020; Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2020), na jep indikacion që punësimi dhe pagat do kenë një rënie më të madhe sesa ajo e krizës financiare të vitit 2008. Edhe viti

pasues pritet të jetë i vështirë, me një këndellje të lehtë të pritshme në pjesën e dytë të vitit të ardhshëm derisa kushtet e përgjithshme ekonomike dhe sociale pritet të përmirësohen në mënyrë thelbësore në vitin 2022. Skenari i dytë më pozitiv për një rimëkëmbje më të shpejtë do të përfshinte tri gjëra: i) një stimulim fiskal të koordinuar në zonën e euros me efekte shpërndarëse materiale edhe për Kosovën; ii) Kosovës dhe rajonit t’i alokohen ndihma të jashtme financiare (pa masa shtrënguese nga ndihmëdhënësit), duke lënë hapësirë edhe për disa masa stimuluese ekonomike të limituara; dhe iii) testimi masiv të niset shpejt në rajon duke lejuar një kthim më të shpejtë të jetës normale ekonomike. Në këtë skenar, sipas WIIW, pritet një tkurrje më e vogël e BPV-së në shkallë reale në 2020, me një rimëkëmbje të denjë në 2021¹¹.

Në një skenar të tretë, më negativ, të analizuar nga (BiEPAG, 2020)¹², një rënie e thellë e aktivitetit ekonomik në rajon do të shkaktojë situatën e dështimit të shumë bizneseve. Mbyllja e bizneseve e shoqëruar me papunësi do të shpjerë në mospagesë të borxheve në institucione financiare duke kthyer një krizë shëndetësore në një krizë financiare. Ky skenar jo vetëm që nënkupton një rënie të thellë ekonomike në 2020 (me një rënie potenciale të BPV-së reale në mes 5-10 për qind, dhe vështirësi të mëdha për popullatën) me papunësi të lartë, paga të ulëta dhe rritje të papërfillshme ekonomike për disa vite.

11 <https://wiiw.ac.at/eastern-europe-coronavirus-tracker-economic-impact-rising-n-439.html>

12 <https://biEPAG.eu/wp-content/uploads/2020/04/BiEPAG-Policy-Brief-The-Western-Balkans-in-Times-of-the-Global-Pandemic.pdf>

4.2. VLERËSIMET NGA PERSPEKTIVA E BIZNESEVE

Instituti Riinvest ka intervistuar në pjesën e parë të qershorit udhëheqësit e 35 kompanive reprezentative e me peshë thuaja nga të gjithë sektorët me kontribut në krijimin e GDP-së, përkatësisht vlerën e re në Kosovë. COVID-19 ka goditur rëndë operacionet e kompanive kosovare duke reduktuar shitjet (përpos tregtisë) nga 10 % deri në 90%) në periudhën mars - 18 maj, duke përjashtuar akomodimin në hotele dhe gastronominë ku kuptohet goditja ka qenë me ndërprerje të punës. Pas 18 majit dhe në fillim të qershorit situata është përmirësuar në gjithë sektorët dhe reduktimi i shitjes është zvogëluar në 20- 50% në krahasim me gjendjen para pandemisë, me përjashtim të hoteleve ku ende kapacitetet shfrytëzoheshin jo më shumë se 3-5% (Tabela 8). Dy sektorë të industrisë përpunuese kanë pasur rritje dhe atë prodhimi i qumështit dhe miellit nën ndikimin e mbylljes së kufijve dhe vështirësive për import. Gjithashtu sipas vlerësimeve të ekspertëve prodhimi i drithërave do të ketë një rritje prej rreth 10%. Disa restorante dhe kafene në qershor kanë arritur të zhvillojnë një aktivitet prej 30-40 % në krahasim me situatën para pandemisë. Përjashtim nga këta trendë në maj dhe qershor bën tregtia ku shitjet janë zvogëluar në krahasim me mars dhe prill rreth 10-20 %, për shkak të efekteve psikologjike në fazën e parë por edhe nga efekti i rënies së fuqisë blerëse në fazën e dytë¹³.

Pozitive është se sipas këtyre intervistave, e që është një karakteristikë e shprehur, nuk ka ndodhur zvogëlimi i punësimit dhe nuk ka pasur përjashtime nga puna, mirëpo trendi këtu sigurisht varet se si do të zhvillohet situata më tutje dhe nga zbatimi i Programit të rimëkëmbjes. Për dallim nga kjo të gjitha këto kompani kanë ndërprerë ose shtyrë investimet në një rang nga 50,000 – 4,000,000 euro. Dhe kjo padyshim është problemi kyç që duhet adresuar me Programin e rimëkëmbjes. Udhëheqësit e kompanive e shohin një faktor shumë të rëndësishëm të rimëkëmbjes, me një efekt të theksuar shpërndarës (spillover), mbajtjen e nivelit të theksuar të remitencave dhe konsumin e diasporës në Kosovë

gjatë vizitave të tyre sidomos verës – “Turizmi i diasporës”. Jo vetëm restorantet e tregtia, por edhe industria ushqimore, ndërtimtaria, patundshmëritë, bankat, shërbimet pa dallim, dhe thuaja gjithë të intervistuarit kërkojnë kategorikisht që të merren të gjitha masat e nevojshme e të krijohen parakushtet për të mundësuar fluksin e bashkatdhetarëve tanë nga diaspora gjatë sezonit veror në numër sa më të madh. Situata në KEK dhe Trepçë duket se nuk ka pësuar goditje me rënie prodhimi. Te KEK-u mund të paraqitet problem shtyrja e remontit për 9 muaj te Kosova B, si dhe vonesat e pagesave nga KEDS-i. Ndërkaq Trepça edhe pse ka një rritje të prodhimit të koncentratit, goditet nga rënia e çmimeve në tregun botëror. Sektori bankar mbetet stabil. Kishte një rënie drastike të kreditimit në periudhën mars-maj, por kjo ngadalë po tejkalohet përgjatë qershorit. Ndonëse ka një rritje të depozitave, problem paraqitet përkeqësimi i portfolios së tyre për shkak të mungesës së deponimeve nga jashtë sidomos nga diaspora. Bankat po përgatiten për një ristrukturim të kredive, duke përfshirë edhe mundësinë e moratoriumit për persona fizikë, të plotë ose të pjesshëm.

Thuaja pa përjashtim të intervistuarit nuk kanë ndjerë efekte për t'u përmendur nga Pakoja emergjente. Ata kanë pritje serioze nga Programi i rimëkëmbjes, siç është proklamuar nga Qeveria. Rekomandimet e tyre lidhur me atë se çfarë duhet të përmbajë ky program janë shumë të arsyeshme dhe larg një liste dëshirash. Ato fokusohen në lehtësimin e qasjes në financa, lehtësimin e kushteve të kredisë, duke subvencionuar ose mbuluar tërësisht interesat, duke zgjatur afatin e pagesave, riprogramuar kreditë, siguruar pushim (grace period) në kthimin e obligimeve kreditore. Ka një kërkesë që me masa përkatëse të ndikohet për zvogëlimin e interesave në kredi për investime afatgjatë deri në përgjysmim të tyre. Është interesant se ka pasur pak insistim në grante dhe mjete pa kthim. Kjo ndoshta shpjegohet me faktin se kemi të bëjmë me kompani të etabluara. Shumë kërkesa në fushën

¹³ Intervista gjysmë të strukturuara e të thëlluara me kompani nga sektorë të ndryshëm (qershor 2020).

e politikës fiskale ndërlidhën me zbatimin korrekt dhe përsosjen në disa segmente të Pakos fiskale 1 dhe 2, duke theksuar efektet pozitive të saj edhe deri tani. Duket se ende ka disa (jo shumë) probleme serioze lidhur me tarifatat dhe TVSH-në tek importi i inuteve për prodhim, sidomos tek importi i ambalazhës së paketimit. Shumë kërkesa janë të lidhura për mbështetjen e eksportit, i cili deri tani nuk ka qenë në fokus të intervenimeve qeveritare. Sistemi i TVSH-në duket se do një rishqyrtim së paku në disa sektorë (1) të grumbulluesit e produkteve primare bujqësore (2) të restorantet ku ka një problem serioz që është krijuar pas përshkallëzimit të TVSH-së në 8 dhe 18% në vend të normës lineare prej 16% që ishte më parë; ata blejnë inputet me 8% e duhet të shkarkohen me 18% dhe kjo krijoi një shpërpejtje dhe dëmtim të tyre. (3) Ndërtimtarët që merren edhe me patundshmëritë konsiderojë se ngarkimi i tyre me 18% TVSH për shërbime duhet të rishqyrtohet. Këtu duhet shtuar edhe procedurat e gjata dhe burokratike të rimbursimit të TVSH-së duke përfshirë edhe eksportuesit.

Një brengë e posaçme e udhëheqësve të kompanive ka të bëjë me ruajtjen e punësimit dhe fuqisë së aftë punëtore dhe lidhur me këtë e shohin zgjidhjen të mbështetja me një lloj subvencionimi e edhe deri te solidariteti i sektorit publik. Një çështje tjetër e potencuar ka qenë insistimi në fiskalizim dhe ulje të informalitetit (shembull banderolat e miellit).

Duket se Kosova ka nevojë që gjithsesi ti shohë gjithë mundësitë e mbështetjes së eksportuesve, një subvencionim i kujdesshëm, për shembull çanta kreditimi për shpenzimet e transportit, ose linja të veçanta kreditimi (IFC, EBRD). Mbetet një problem që potencohet një kohë të gjatë lidhur me akcizën e prodhuesve të lëngjeve që sipas tyre i bënë të pabarabartë në treg, pasi disa vende në rajon nuk e kanë këtë akcizë (Serbia, Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut) dhe kështu krijohet përparësi konkurruese ndaj prodhuesve kosovarë). Një problem mjaft i shprehur ka të bëjë me raportet me rrjetin tregtar dhe qendrat tregtare, e të cilat prodhimi vendor detyrohet t'i kreditojë deri në 90 ditë, shumë ndryshe nga mallrat që marrin tregtarët e importit. Ndaj ka pasur propozime që të nxirret një ligj lidhur me detyrimet për pagesa në transaksionet biznesore.

TABELA 9. VLERËSIMET E UDHËHEQËSVE TË KOMPANIVE NË SEKTORË TË NDRYSHËM LIDHUR ME EFEKTET E COVID-19

	SEKTORËT	Mars – Maj	Qershor
1	Bujqësia (prodhimi primar)		
	Prodhimi i drithërave		+10%
	Pemët e perimet		-10 deri -20 %
2	Industria përpunuese		
	Përpunimi i pemëve e perimeve	-80%	-50%
	Pijet dhe lëngjet	-20% deri -50%	-10%deri -20%
	Përpunimi i mishit	-20 deri -40%	-10% deri -20%
	Përpunimi i qumështit	+20%	+20%
	Prodhimi i miellit	+20%	+10%
	Përpunimi i drurit	-80%	-20%
	Përpunimi i metaleve	-30%	-20%
	Materialet ndërtimore	-50%	-40%
3	Tekstili	- 80%	-50%
	Plastika	- 35%	-20%
4	Grafika	-30 %	-20%
	Ndërtimi		50%
5	Patundshmëritë		-50 deri -70%
	Tregtia	+10 deri +30%	-10 % deri -20%
6	Akomodimi dhe ushqimi		
	Hotelet	mbyllur	-95%
	Restorantet	mbyllur	-60 deri -65%
7	Kafenetë e vogla	-50%	-50%
	Trepça	Pa ndryshime	Rritje e prodhimit
8	KEK-u	Sipas planit	Sipas planit

5. INTERVENIMET QEVERTARE

5.1. PAKOJA EMERGJENTE

Disa masa në fushën ekonomike që janë praktikuar në shume vende, ku më shumë e ku më pak, kryesisht kanë të bëjnë me:

- Reduktimin e shpenzimeve qeveritare dhe ato të sektorit privat për shpenzime jo të domosdoshme kapitale (ndërtimet e objekteve, infrastruktura jo e domosdoshme, veturat, e të ngjashme)
- Shtyrja e pagesave për kredi, për tatime e kontribute
- Asistenca sociale për të papunët dhe të varfrit

Me fillimin e aplikimit të masave kufizuese me qëllim të parandalimit dhe ngadalësimit të përhapjes së virusit në vend, Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT) në bashkëpunim me ministritë e tjera të linjës si dhe shoqatat e bizneseve, përpiluan planin fillestar së bashku me Pakon emergjente për ballafaqimin e goditjes së shkaktuar nga pandemia. Reagimi i Qeverisë ishte i menjëhershëm dhe u konsiderua si një hap i mirë drejt lehtësimit të pasojave të krizës. Pakoja u aprovua më 3 prill të këtij viti ndërsa shuma totale e saj ishte rreth 180 milionë Euro të shpërndara në 15 masa të ndryshme (Tabela 1). Meqenëse koha ishte e shkurtër dhe reagimi ishte i shpejtë, pothuajse që i pamundur një debat gjithëpërfshirës lidhur me masat. Gjithsesi, komuniteti i biznesit i përfaqësuar përmes shoqatave e asociacioneve të ndryshme ishte aktiv gjatë gjithë procesit.

Rreth 50% e vlerës së kësaj pakoje ishte e destinuar për përkrahje direkte financiare për sektorin privat duke përfshirë subvencionimin e një pjese të pagave, shpenzimet e qirasë dhe kontributet pensionale të punëtorëve. Pjesa tjetër e masave ishte e paraparë për përfituesit e skemave sociale në Kosovë, komunitetet jo shumicë, si dhe grante dhe subvencione në bujqësi apo aktivitete kulturore. Masat përveç

asistencës financiare kishin për qëllim edhe rritjen e punësimit formal. Një shumë prej 6 milionë eurosh ishte ndarë për bizneset të cilat regjistrojnë punëtorë të rregullt me kontratë pune të paktën njëvjeçare. Gjithashtu, vlen të theksohet se njëra nga masat ishte e paraparë vetëm për bizneset eksportuese edhe pse nuk ishin bërë të qarta kushtet dhe mënyra e përfitimit nga kjo masë.

Pavarësisht që vendimi për Pakon emergjente ishte marrë qysh në fillim të muajit prill, distribuimi i plotë i fondeve nga kjo pako nuk është bërë ende. Sipas deklaratave të deritanishme të zyrtarëve qeveritarë, përkatësisht Ministrisë së Financave dhe Transfereve, vetëm një e treta e buxhetit prej rreth 180 milionë eurosh është disbursuar deri më tani. Arsyet për vonesa të tilla duket të jenë kryesisht të natyrës burokratike dhe kufizimet buxhetore që kërkonin rishikim të buxhetit. Me Ligjin për Buxhetin e vitit 2020, nuk ishin të parapara shpenzime të tilla, andaj në mungesë të fondeve të mjaftueshme emergjente duhej rishikuar buxheti dhe duheshin bërë ndryshimet e nevojshme ligjore. Duket se kjo u nënçmua nga ish-Qeveria. Sipas përfaqësuesve të shoqatave të bizneseve në Kosovë, disa nga masat e pakos nuk kanë filluar të zbatohen fare përderisa pjesa tjetër e masave është realizuar vetëm pjesërisht. Masa që ishte e paraparë të mbulonte deri në 50% të shpenzimeve të qirasë për muajt prill dhe maj për bizneset në vështirësi financiare (shih masa 3b) nuk është zbatuar deri më sot. Gjithashtu subvencionimi i pagave në vlerë prej 170 eurosh të parapara për muajt mars dhe prill, është realizuar vetëm për një muaj pavarësisht që sipas vendimit ekzekutimi i pagesave do të duhej të bëhej në muajt prill dhe maj. Për më tepër, një numër jo i vogël i punëtorëve ende nuk kanë pranuar pagesat për muajin e parë. Mbi 30 mijë biznese dhe rreth 140 mijë punëtorë kishin bërë aplikimin për të përfituar nga masat e parapara për kategori të ndryshme. Në njërin anë kapacitetet e limituara institucionale për t'u përballur me një fluks kaq të madh kërkesash, ndërsa në anën tjetër aplik-

acionet jo të plota kishin vështirësuar tej mase administrimin e implementimit të masave. Ndikim jo të vogël pati edhe kriza e fundit politike dhe ndryshimet pasuese në skenën politike të cilat pamundësuan ndryshimet buxhetore të domosdoshme për implementimin e plotë të pakos. Pra, Pakoja emergjente edhe pse ishte paraparë të shërbente si terapi për lehtësimin e gjendjes ajo pothuajse e humbi qëllimin e saj. Kjo ngase me fillimin e heqjes së masave restriktive dhe hapjen graduale të ekonomisë do të duhej të ishte implementuar në tërësi dhe kështu të fillonte së zbatuari një pako e re me masa më agresive për rimëkëmbjen ekonomike.

Me paraqitjen e rasteve të para të të infektuarve në Kosovë dhe marrjen e menjëhershme të masave restriktive, pjesa dërrmuese e sektorëve të ekonomisë kishin pezulluar aktivitetin e tyre. Të gjendur para një situatë të paprecedentë, sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IK-SHP), Qeveria e Kosovës krahas dizajnit të Pakos emergjente, në koordinim me shoqatat e bizneseve përpiluan një plan dinamik të shtrirë në disa faza me zbatimin e masave restriktive. Pavarësisht numrit relativisht të vogël të rasteve të infektuara dhe pasojave të paparashikueshme nga këto masa, reagimi i komunitetit të biznesit ishte në frymën e bashkëpunimit dhe solidarizimit me të gjitha institucionet shtetërore në ballafaqim me pandeminë. Gjatë fazës së parë të mbylljes dhe kufizimit të lëvizjes për qytetarët e Kosovës, përveç industrisë ushqimore, asaj farmaceutike si dhe sektorit të shitjes së mallrave ushqimore, pothuajse të gjitha aktivitetet e tjera ishin paralizuar.

Në bazë të rezultateve të anketës së realizuar nga shoqatat e bizneseve në muajin prill, rreth 95% e bizneseve të anketuara kishin raportuar se kriza e shkaktuar nga pandemia kishte pasur efekt negativ¹⁴. Vlen të theksohet se ky perceptim ishte i ngjashëm pothuajse në të gjithë sektorët ekonomikë ndërsa kishte korrelacion pozitiv mes madhësisë së bizneseve dhe efektit që kriza kishte në to. Për më tepër, më shumë se gjysma e tyre kishin deklaruar

se janë të shqetësuar për mbijetesën e tyre dhe kjo brengë është më e shprehur te ndërmarrjet e vogla dhe mikro; rreth 80% e bizneseve kishin raportuar rënie të shitjeve të tyre. Sa i përket punësimit, gati një e treta e bizneseve kishin deklaruar se qysh në javën e tretë të pandemisë numri i punëtorëve të tyre ishte reduktuar. Gjithnjë sipas kësaj ankete, rreth 6% e bizneseve të intervistuar kishin larguar të gjithë punëtorët nga puna si pasojë e krizës. Shumica e bizneseve, po ashtu, ishin shprehur se kanë qenë të kënaqur me qartësinë e vendimeve të qeverisë lidhur me masat kufizuese. Në anën tjetër, Pakoja emergjente dhe masat e parapara në këtë pako ishin parë me skepticizëm nga sektori privat në Kosovë. Sipas tyre, masat më shumë kishin karakter social dhe si të tilla nuk mund t'i adresonin problemet akute të shkaktuara nga mbyllja e përkohshme e pjesës dërrmuese të ekonomisë. Nga rezultatet e kësaj ankete shihet se vetëm një e katërta e bizneseve i kishin parë masat si lehtësuese përderisa pjesa tjetër nuk ishin të bindur. Gjetje të ngjashme ishin raportuar edhe në një studim tjetër të realizuar nga kompania e hulumtimeve Pyper¹⁵. Sipas të dhënave të këtij studimi, bizneset kishin vlerësuar kompensimin e pagave si masën më të dobishme të Pakos emergjente ndërsa 95% e tyre kishin deklaruar se duhen masa shtesë në funksion të lehtësimit të pasojave nga pandemia. Gjithsesi, shumica e pagës së kompensuar prej 170 eurosh, ekuivalente me pagën minimale në Kosovë, ishte perceptuar si shumë e ulët nga bizneset. Karakteri gjithëpërfshirës i masave kishte indinjuar një pjesë të bizneseve që nuk mund të ushtronin aktivitetin e tyre ngase jo të gjitha bizneset ishin prekur njësoj nga masat kufizuese. Pavarësisht kufizimeve buxhetore, komuniteti i biznesit pretendon që pakoja do të duhej të ishte diskriminuese duke pasur në fokus ata sektorë të cilët janë goditur më së tepërmi nga situata e krijuar. Andaj, duke parë që pritjet e tyre nuk ishin realizuar gjatë fazës emergjente si dhe duke parë vështirësitë gjatë implementimit të pakos fillestare, komuniteti i biznesit duhet të ketë rol aktiv dhe duhet të jetë mirë i përfaqësuar në diskutimin rreth masave për rimëkëmbjen ekonomike të vendit.

14 Mbledhja e të dhënave është bërë nga kompania Recura me iniciativë të shoqatave të bizneseve në Kosovë përfshirë Odën Ekonomike të Kosovës, Odën Ekonomike Amerikane, Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare, Këshillin e Investitorëve Evropianë, si dhe Klubin e Prodhuesve të Kosovës.

15 Ky hulumtim është realizuar në bashkëpunim me Institutin Riinvest, Odën Ekonomike të Kosovës dhe Odën e Afarizimit të Kosovës. Të dhënat janë mbledhur nga 680 biznese anëmbanë Kosovës.

5.2. PROGRAMI I RIMËKËMBJES

Programi qeveritar i aprovuar në qershor të këtij viti dhe i ndërlidhur me rishikimin e buxhetit parasheh një intervenim prej 1,2 miliard eurosh dhe atë gjatë vitit 2020 dhe 2021 (Shih Aneksi 2 i këtij raporti). Ky program ka 2 komponentë themelorë- masat urgjente në mbështetje të bizneseve për të penguar daljen e tyre nga tregu dhe rimëkëmbjen ekonomike. Ky dokument është operacionalizuar me aktivitete e bartës të tyre dhe indikacione lidhur me burimet financiare. Në hapin e mëtejshëm duhet të bëhet edhe planifikimi kohor i aktiviteteve.

Programi i rimëkëmbjes përmban këta komponentë përkatësisht aktivitete e masa:

- Lehtësimi i qasjes në financim
- Zvogëlimi i barrës tatimore
- Mbështetja e punësimit
- Mbështetja e bujqësisë
- Masat për stimulim të kërkesës agregate
- Mbështetje për ndërmarrje publike për operim të rregullt dhe investime kapitale të rëndësishme strategjike
- Rishikimi i buxhetit për 2020 dhe relaksimi i kufizimeve fiskale dhe i borxhit publik
- Masa mbështetëse për ekonomi nga sektori financiar
- Mobilizimi për financimin e masave

Programi qeveritar duket mjaft i fokusuar dhe i strukturuar dhe i qartë në objektivat e tij dhe i arsyeshëm edhe sa i përket vëllimit të paraparë të intervenimit. Ky program padyshim do të mund dhe duhet të përmirësohet në disa aspekte në linjën e kërkesave të bizneseve që u prezantuan më lart. Problemi kryesor është se këtu nuk shohim ndërlidhjen e domosdoshme midis boshtit shëndetësor dhe atij ekonomik. Nuk ka një indikacion për investime të shpejta në konsolidimin e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore në aspektin e kapaciteteve teknike, pajisjeve dhe kapaciteteve humane dhe përmirësimit të kushteve të punës së tyre për të përballuar situata serioze siç është kjo me COVID-19. Kjo si duket është një sfidë shumë serioze dhe që kërkon një nivel tjetër të intervenimeve prej atyre që kemi pasur këto dy dekada. Problemi tjetër po ashtu i rëndësishëm është se, sa dhe kur ky program do të mund të bëhet operativ dhe i zbatueshëm e që lidhet me situatën e rënduar politike, problemet me funksionimin e Kuvendit dhe dialogun me Serbinë.

6. SITUATA POLITIKE DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE

Se situata është për t'u marrë shumë seriozisht e dokumenton edhe raporti i Institutit Riinvest në kuadër të këtij projekti, i cili dokumenton se infuzioni nga Pakoja emergjente prej rreth 180 milionë eurosh është zbatuar vetëm 30% për shkak të problemeve e kapaciteteve teknike por edhe neglizhencës që të krijohen kushtet për rishikim të buxhetit nga Qeveria e Kuvendi¹⁶ dhe forcat politike në Kuvend. Marrëveshjet me institucionet financiare ndërkombëtare, kryesisht me FMN-në, që ndërlidhen me të dyja -Pakon emergjente (Qeveria e kaluar) dhe Programin e rimëkëmbjes të proklamuar nga Qeveria e re ende mbasin peng i mosratifikimit që ka burimin në divergjencat partiake që dëmton shumë ekonominë e vendit jo vetëm tash por thuaja një dekadë, por tani me një tendencë përkeqësimi në një situatë kritike¹⁷. Dy seancat e fundit të Kuvendit të Republikës së Kosovës përfunduan pa asnjë efekt dhe në kuadër të një përballje të ashpër konfrontuese dhe me një diskurs që dëmton imazhin dhe rolin e këtij institucioni. Përderisa debati në shoqëri lidhur me pasojat ekonomike e sociale të COVID-19 është intensifikuar, ai nuk duket sa duhet i bazuar në hulumtime të paanshme duke qenë i ngarkuar nga këndvështrimet e veçanta sektoriale ose intereseve parciais e politike. Një debat joproduktiv kemi mundur ta shohim edhe në dy seancat e fundit të Kuvendit të Kosovës dhe atë në të tri boshtet – (1)

trendët e infektiveve dhe shkaqet e rritjes së tyre (2) shtyrja e aprovimit të rishikimit të buxhetit për 2020 dhe shtyrja e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë efekte te kompletimi i burimeve të financimit për Programin e rimëkëmbjes dhe (3) konflikti i ashpër politik që ka ngushtuar horizontin e mendimit të arsyeshëm e të përgjegjshëm. Situata është tejet serioze në të tri boshtet. Megjithatë, duket se konsolidimi i funksionimit të institucioneve është përcaktues për dy të parat. Mirëpo mbetet që të shihet si mund të tejkalohet konflikti joproduktiv politik. Primesat e luftës primitive politike kanë hyrë thellë në mënyrën e të menduarit dhe vepruarit të shumë akterëve politikë, por nga kjo fatkeqësisht nuk është immune as një pjesë e konsiderueshme e opinionit, mediave dhe shoqërisë civile. Ndoshta pikërisht ndryshimi duhet të fillojë nga këta të fundit.

Situata është bërë edhe më e ndjeshme rreth Gjykatës Speciale në Hagë dhe dialogun me Serbinë për të cilin partnerët kryesorë ndërkombëtarë të Kosovës janë insistues. Zgjedhjet e reja në këto kushte nuk duken oportune edhe për shkak të pandemisë e edhe mosgatishmërisë së shumicës dërrmuese të forcave politike. Andaj edhe në këtë situatë mbetet esenciale që forcat politike të përballojnë shtytësit e interesit të ngushë dhe të krijojnë konsensus bazik në çështjet kyçe të interesit shtetëror.

16 Shih seancat e Kuvendit RKS (qershor dhe korrik 2020)

17 Shih debati në Kuvendin e Kosovës

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kufizimi i lëvizjes për qytetarët dhe pezullimi i aktiviteteve biznesor në shumë sektorë shkaktoi rënie të ndjeshme të aktiviteteve ekonomike në vend. Masat kufizuese shkaktojnë rënie drastike të kërkesës agregate. Qeveria e Kosovës në mars të këtij viti aprovoi Pakon fiskale emergjente me 15 masa si reagim për lehtësimin e pasojave të shaktuara nga pandemia. Vlera totale e kësaj pakoje në terma nominalë ishte 180 milionë euro apo rreth 2.5% e BPV të Kosovës por ajo deri në qershor arriti të realizohet vetëm 30% dhe kjo la pasojë në efektet e saj e sidomos të biznesit e goditura.

Situata epidemiologjike dhe nën influencën e saj ajo ekonomike edhe në planin global dhe në atë nacional, po zhvillohet më shumë sipas skenarëve jo aq të vulltshëm (shih Skenari A1 më lart). E tërë kjo sepse virusi po shfaqet më rezistues dhe me incidencë edhe në tremujorin e tretë të vitit. Andaj institucionet prestigjioze ndërkombëtare duke përfshirë edhe FMN-në kanë korrigjuar projeksionet duke parashikuar një tkurrje më të madhe ekonomike sesa që parashihej në fillim. Projeksionet për tkurrjen ekonomike në Kosovë sillen nga 3% (Qeveria e Kosovës) deri në 5% (FMN, RIINVEST), pasiguria lidhur me trendet është e madhe dhe varet nga (1) efektiviteti në kontrollin e përhapjes së COVID-19 (2) efektiviteti i zbatimit të masave të Programit të rimëkëmbjes ekonomike dhe (3) stabiliteti politik dhe konsolidimi i funksionimit të institucioneve. Ndikimet e deritashme në nivelin biznesor janë shumë të mëdha në rënie të shitjes dhe ndërprerje të investimeve (shih Tabela 8). Shikuar në tërë këtë kontekst parashikimet qeveritare lidhur me konfiguracionin makroekonomik duken optimiste. Kjo rëndohet edhe më shumë sepse ngjashëm me shumicën e vendeve të rajonit (sidomos Maqedoninë dhe Shqipërinë) ka rritje të numrit të të infektuarve dhe rasteve aktive. Situata e brishtë politike dhe paaftësia e faktorit politik që të ngritët mbi interesat e ngushta e të sigurojë një unitet dhe konsensus minimal për t'u përballur me situatën ngërthen rreziqe serioze

në aprovimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që ndërliken me asistencën financiare, me rishikimin e buxhetit dhe me vënien në jetë të gjithë segmenteve të programit të rimëkëmbjes. Duket se edhe investimet serioze në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe humane të institucioneve të shëndetit publik janë në vonesë. Kosova ka një nivel të ulët tejet kritik të financimit qeveritar të shëndetësisë me vetëm rreth 3% GDP larg të gjitha vendeve të rajonit dhe të mos flasim për standardet evropiane. Programi qeveritar i rimëkëmbjes duket të jetë i goditur në pjesën më të madhe, por gjithnjë mbetet i hapur problemi i kapaciteteve absorbuese të përfituesve dhe zbatuesve të këtij programi. Në kuadër të programit do të ishte e dobishme të adresohen edhe disa modifikime të politikave dhe masave në linjën e kërkesave të bizneseve (shih pikën 4.2. të këtij raporti).

Riinvest konsideron se këto janë rekomandimet e natyrës emergjente e me prioritet:

(1) Rritja e përgjegjësisë së subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe konsolidimi urgjent i funksionimit të Kuvendit ashtu që të mund të marrë vendime me shumicën e kualifikuar kur është fjala për marrëveshjet ndërkombëtare dhe shumicën e thjeshtë për çështjet e tjera.

(2) Përfshirja urgjente e sektorit të shëndetësisë me intervenim të strukturuar dhe të kuantifikuar e me burime të sigurta deri në 4-5% të GDP-së sivjet dhe 6% vitin e ardhshëm dhe me prioritet për investime të shpejta për rritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve teknike, pajisjeve dhe kapaciteteve humane si dhe për përmirësimin e kushteve të punës në këtë sektor për të përballuar situata serioze siç është kjo me COVID-19 ose të ngjashme.

(3) Riinvest rekomandon që nga fondet e privatizimit të bëhet sa më parë një investim domethënës për ndërtimin e një Klinike moderne, me pajisjet që do të mund mundësonin të gjitha analizat dhe shqyrtimet diagnostike me standarde evropiane duke përfshirë këtu edhe aftësimin e shpejtë të stafit vendor për përdorimin e tyre në kuadër të një bashkëpunimi me ekspertë ndërkombëtarë për një periudhë të caktuar kohore. Kjo do të reduktonte dukshëm nevojën për të shpenzuar fonde publike e private jashtë vendit dhe siguron një barazi në qasje në shërbime cilësore për gjithë qytetarët e vendit;

(4) Rekomandohet përmirësimi i politikave fiskale:

(a) Lidhur me evitimin e ngarkesat tarifore dhe TVSH-së për disa inpute prodhimi në kufi

(b) Evitimi i problemeve të rimbursimit të TVSH-së

(c) Shqyrtimi i kërkesave rreth TVSH-së të grumbulluesve të produkteve primare bujqësore, restoranteve, ndërtimtarëve dhe eksportuesve

(d) Gjithashtu është i nevojshëm edhe shqyrtimi i arsyeshmërisë së akcizës për prodhuesit e lëngjeve dhe vënia e tyre në pozitë të barabartë me konkurrentët nga vendet fqinje lidhur me këtë çështje;

(e) Nxitja e fiskalizimit dhe zbatimi i banderolave për disa produkte

(5) Nxjerrja e ligjit për afatet e pagesave të llogarive midis bizneseve dhe qeverisë e bizneseve dhe rregullimi me Ligjin mbi Tregtinë e Brendshme midis prodhuesve dhe tregtisë.

(6) Krijimi i mekanizmave në kuadër të Qeverisë dhe akterëve të tjerë për zbatimin e Programit të rimëkëmbjes, duke përfshirë monitorimin e efekteve në ekonominë e vendit dhe sektorë të caktuar, transparencën dhe llogaridhënien.

(7) Krijimi i një Plani aksional për të siguruar ardhjen e mërgimtarëve në pushimet verore në Kosovë (sigurimi i testeve dhe evitimi i pengesave të tjera).

ANEX

ANEKS 1: PAKOJA EMERGJENTE FISKALE¹⁸

Masa 1	Pagesa e dyfishtë e vlerës së skemës sociale për të gjithë përfituesit e skemave sociale për muajin prill dhe maj	€ 7,650,000
Masa 2	Pagesa shtesë prej 30 eurosh për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore me vlerë deri në 100 euro	€ 13,000,000
Masa 3a	Mbështetje financiare për bizneset në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të pandemisë: Pagat mujore të punëtorëve në vlerë prej 170 eurosh	€ 41,000,000
Masa 3b	Mbështetje financiare për bizneset në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të pandemisë: Subvencionimi i qirasë	€ 12,000,000
Masa 3c	Mbështetje financiare për bizneset në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të pandemisë: Kontributet pensionale të punëtorëve	€ 8,000,000
Masa 4	Huadhënie pa interes për ndërmarrjet publike në vështirësi financiare për shkak të pandemisë	€ 20,000,000
Masa 5	Mbështetje financiare për komunat që janë ndikuar në përballje me pandeminë	€ 10,000,000
Masa 6	Sigurimi i shtesës mbi pagë në vlerë prej 300 eurosh për punëtorët në terren dhe që janë drejtpërdrejt të ekspozuar ndaj rrezikut të infektimit në punën e tyre	€ 15,000,000
Masa 7	Pagesë shtesë në vlerë prej 100 eurosh për punëtorët e dyqaneve ushqimore, barnatoreve, furrave, për muajin prill dhe maj	€ 3,000,000
Masa 8	Asistencë mujore në vlerë prej 130 eurosh për qytetarët e Kosovës që humbin vendin e punës për shkak të situatës emergjente	€ 4,000,000
Masa 9	Mbështetje për iniciativat që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, që janë goditur më rëndë nga situata emergjente për shkak të pandemisë	€ 2,000,000
Masa 10a	Sigurimi i likuiditetit financiar: Ndërmarrjet mikro dhe të vetë-punësuarit nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit për Garanci Kredituese	€ 15,000,000
Masa 10b	Sigurimi i likuiditetit financiar: Bizneset e autorizuara që ofrojnë shërbime bazike të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike me kthim deri më 31.12.2020	
Masa 11	Rritje e buxhetit për grante dhe subvencione në bujqësi	€ 5,000,000
Masa 12	Rritje e buxhetit për grante dhe subvencione Ministrisë së Kulturës	€ 5,000,000
Masa 13	Mbështetje për eksportuesit	€ 10,000,000
Masa 14	Mbështetje financiare për bizneset që regjistrojnë punëtorë me kontratë pune së paku një (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës emergjente në vlerë prej 130 eurosh për dy muaj pasues pas regjistrimit	€ 6,000,000
Masa 15	Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej 130 eurosh për qytetarët me kushte të rënda sociale të lajmëruar të papunë dhe që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës	€ 3,000,000
Totali		€ 179,650,000

ANEKS 2: RIMËKËMBJA EKONOMIKE PAS PANDEMISË¹⁹

Qeveria e re do të ketë program të veçantë për rimëkëmbje ekonomike, pasi që, përveç ndikimit në shëndetin publik dhe në jetën e qytetarëve, COVID-19 do të shkaktojë një shok ekonomik, duke ndikuar negativisht në prodhim, punësim, të ardhura dhe eksporte, dhe kjo vetëm si një valë e parë. Ndikimin e plotë do ta ndiejmë në pjesën e dytë të vitit 2020, kur të shfaqen efektet multiplikuese, përmes rënies së investimeve dhe remitencave.

Masat për rimëkëmbje ekonomike do të bazohen në një analizë të përgjithshme të ndikimit ekonomik të COVID-19. Këto masa do të përmbliken në kuadër të “Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike pas Pandemisë COVID-19”, i cili program do të mobilizojë mbi 1 miliard euro gjatë vitit 2020 dhe 2021 që do të futen në ekonomi. Do të themelohet Fondi për rimëkëmbjen ekonomike pas pandemisë COVID-19, ku do të grumbullohen mjetet që do të dedikohen për qëllime të mbështetjes ekonomike dhe sociale për t’i tejkaluar pasojat e pandemisë.

Masat e menjëhershme për parandalim të daljes së bizneseve nga tregu

Ndikimi ekonomik i kësaj pandemie mund të jetë i paprecedent, sepse në të njëjtën kohë kemi kolapsim të ofertës agregate dhe reduktim të ndjeshëm të kërkesës agregate. Oferta agregate ka kolapsuar pasi shumë firma janë mbyllur me vendime administrative apo si rezultat i shkëputjes së zinxhirit ofertues/prodhues, si dhe kufizimit të lëvizjes të njerëzve/punëtorëve.

Prandaj, do të merren masa të menjëhershme që sa më parë të normalizohet funksionimi i bizneseve, por duke respektuar udhëzimet shëndetësore që të parandalohet përhapja e virusit. Krahas normalizimit të funksionimit të ekonomisë, do të ofrohet mbështetje e menjëhershme financiare për bizneset, për t’i përballuar kostot minimale të operimit dhe mbijetesës gjatë kësaj periudhe. Këto masa do të parandalojnë daljen e bizneseve nga tregu, duke siguruar që kostot ekonomike dhe sociale të pandemisë të jenë më të ulëta, si për bizneset dhe familjet ashtu edhe për shtetin.

Masat për rimëkëmbje për 2020 dhe 2021

Ndërkaq, masat për rimëkëmbje ekonomike, që janë paraqitur në tabelën në vijim, do të sigurojnë rimëkëmbje ekonomike në pjesën e dytë të këtij viti dhe në 2021. Këto masa do t’i mobilizojnë të gjitha burimet e financimit për bizneset. Do të punohet me bankat që financimi afatgjatë i shtetit për biznese të rrjedhë kryesisht përmes bankave. Kështu që, kjo pandemi duhet parë edhe si një mundësi për ndryshime të mëdha cilësore në strukturën ekonomike të Kosovës, me potencial për rritje afatgjatë cilësore. Përmes kanalizimit të fondeve në ekonomi aty ku ka nevojë dhe ku efekti është maksimal, do të krijojnë një momentum të ri për zhvillim të hovshëm ekonomik, duke e vendosur ekonominë e Kosovës në një trajektore më të lartë të rritjes dhe zhvillimit afatgjatë, me punësim më të lartë dhe më cilësor.

18 Burimi: Ministria e Financave dhe Transfereve të Kosovës
19 Programi i Qeverisë së Kosovës, qershor 2020

Masa	Qëllimi i masës dhe përshkrimi	Nënmasa	Implikimet ligjore	Institucionet zbatuese dhe përkrahëse
Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit.	Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit.	Rritja e mbulueshmërisë së kredive të reja përmes Fondit për Garantimin e Kredive, riprogramimi i kredive bankare ekzistuese, ku koston e riprogramimit e merr Qeveria, Subvencionimi i normave të interesit për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevantë.	Konsultim me BQK-në për ndryshimet e nevojshme rregullative që duhet të ndodhin për zbatimin e këtyre masave.	MF, BQK, MTI/Fondi për Garanci Kreditorë, bankat komerciale, odat ekonomike
Zvogëlimi i barrës tatimore	Lehtësimi i barrës tatimore të bizneseve, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër.	Shtyrje e pagesës së tatimeve bazuar në nevojat e bizneseve. Mbulimi i 5-përqindshënit të kontributit pensional që biznesi paguan për punëtorë. Pushimet tatimore për firmat për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevantë. Lirimet për parapagimet e obligimeve tatimore nga ana e bizneseve. Lirimi i bizneseve nga ndëshkimet tatimore për vonesa në pagesën e tatimeve për shkak të pandemisë bazuar në kriteret e qarta dhe transparente. Ofrimi i mundësisë për riprogramim të borxheve tatimore të mëparshme, duke përfshirë edhe zbritjet për pagesën e menjëhershme të borxhit.	Ndryshimi i rregullativës ligjore të fushës së tatimeve dhe kontributeve pensionale, si dhe përgatitja e planit strategjik për mbështetje sektoriale.	Kuvendi, ATK, Dogana, MF, Trusti Pensional i Kosovës, odat ekonomike, komunat.
Masat për mbështetje të punësimit	Rritja e punësimit, në veçanti e grupeve specifike të punëtorëve me gjasa më të ulëta për punësim.	Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese të prekur nga pandemia, Subvencionim i pagës për punëtorët e rinj që marrin bizneset në punë bazuar në një plan që identifikon sektorët dhe kategorinë e punëtorëve më në nevojë. Përkrahja profesionale për biznese për funksionim në kushte pandemie, siç është puna nga shtëpia, puna online, transformimi digital, etj.	Përgatitja e planit strategjik për zbatimin e masave, ku përcaktohen kriteret dhe procedurat për mbështetje të bizneseve për rritje të punësimit.	MPMS, MTI, MF, odat ekonomike, komunat.

<p>Dyfishimi i buxhetit për bujqësi bazuar në Programin për Zhvillim Bujqësor, Rritje e ndjeshme e subvencionimit për hektarë dhe për kokë të bagëtive.</p> <p>Mbështetje për shitje të produkteve bujqësore, në veçanti qumështin e freskë, pemët dhe perimet e freskëta.</p> <p>Zhvillimi i tregjeve lokale bujqësore dhe digjitalizimi i tyre,</p> <p>Mbështetje specifike në përpunimin e produkteve bujqësore dhe në ngritjen e kapaciteteve dhe-ponuese.</p> <p>Subvencionimi i normave të interesit të kredive në bujqësi.</p>	<p>Rishikimi i Programit për Zhvillimin Bujqësor ku parashihen masat, kriteret për zbatim dhe mekanizmat e tjerë të nevojshëm.</p>	<p>MBPZHR, MF, Bankat komerciale, shoqatat e bujqve, komunat.</p>
<p>Rritja e prodhimit bujqësor vendor, për të rritur punësimin në zonat rurale, për të zvogëluar importin e produkteve bujqësore dhe rritur sigurinë e ushqimit sipas standardeve të BE-së.</p>	<p>Rregullativa ligjore për kontributet pensionale, si dhe përgatitja e planeve strategjike ku përcaktohen kriteret për mbështetje financiare për financimin e greis-periudhës.</p>	<p>Kuvendi, MF, Trusti Pensional, BOK, bankat komerciale.</p>
<p>Masat për stimulim të kërkesës agregate</p>	<p>Kthimi i një përqindjeje të mjeteve të kursyera në Trustin Pensional për kontributpaguesit, bazuar në nevojat e tyre, e që kjo mundësi mund të shfrytëzohet për një periudhë 3-mujore, e cila shumë kompensohet nga shteti brenda 5 vjetëve.</p> <p>Mbështetje për zgjatjen e greis periudhës për blerje të banesave dhe shtëpive bazuar në kriteret të të ardhurave.</p>	<p>Kuvendi, MF, Trusti Pensional, BOK, bankat komerciale.</p>
<p>Mbështetje për ndërmarrje publike për operim të rregullt dhe investime kapitale të rëndësishme strategjike</p>	<p>Mbulimi i kostove minimale operative të ndërmarrjeve publike,</p> <p>Rishikim i planit dinamik të investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike dhe vlerësimin i investimeve të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve publike.</p> <p>Mbështetje e investimeve të ndërmarrjeve publike përmes subvencionimit nga buxheti, huadhënies nga buxheti dhe lëshimit të garancioneve sovraane për kredite që ndërmarrjet publike marrin institucionet financiare.</p>	<p>Përgatitja e planit për mbështetje për likuiditet afatshkurtër për ndërmarrjet publike.</p> <p>Përgatitja e planit strategjik për investime të ndërmarrjeve publike për periudha afatgjata.</p> <p>Ndarja e mjeteve përmes rishikimit të buxhetit.</p>
<p>Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike, në veçanti ato investime që janë të natyrës strategjike, që të përballojnë ujin e të hyrave nga inkasimi dhe investimet e nevojshme kapitale që duhet të ndërmarrin.</p>	<p>Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike, në veçanti ato investime që janë të natyrës strategjike, që të përballojnë ujin e të hyrave nga inkasimi dhe investimet e nevojshme kapitale që duhet të ndërmarrin.</p>	<p>Kuvendi, MEA, MF, ndër-marrjet publike, komunat.</p>

<p>Rishikimi i buxhetit për vitin 2020 duhet të ndodhë për të marrë në konsideratë ndikimin e pandemisë në të hyrat buxhetore dhe rishpërndarjen e shpenzimeve bazuar në prioritetet e reja. Krahas ndryshimit të Ligjit të Buxhetit, duhet ndryshuar edhe Ligjin e Financave Publike për të pezulluar përkohësisht rregullat e deficitit buxhetor prej 2% për tri vjet, si dhe Ligjin për Borxhin Publik për të rritur kufirin e borxhit publik nga 40% në 50% të PBB-së.</p>	<p>Identifikimi i hendekut tatimor, Identifikim i kursimeve, Rishpërndarja e shpenzimeve sipas prioriteteve, Pezullimi i rregullës fiskale të deficitit prej 2% për tri vjet, Rritja e kufirit të borxhit publik nga 40% në 50% të PBB-së.</p>	<p>Ndryshimi i Ligjit të Buxhetit, të Ligjit të Financave Publike dhe Ligjit të Borxhit Publik.</p> <p>Kuvendi, Qeveria, komunat.</p>
<p>Rishikimi i buxhetit për vitin 2020 duhet të ndodhë për të marrë në konsideratë ndikimin e pandemisë në të hyrat buxhetore dhe rishpërndarjen e shpenzimeve bazuar në prioritetet e reja. Krahas ndryshimit të Ligjit të Buxhetit, duhet ndryshuar edhe Ligjin e Financave Publike për të pezulluar përkohësisht rregullat e deficitit buxhetor prej 2% për tri vjet, si dhe Ligjin për Borxhin Publik për të rritur kufirin e borxhit publik nga 40% në 50% të PBB-së.</p>	<p>Rishikimi i nivelit të kapitalizimit të nevojshëm për akterët financiarë, Rishikimi i rezervës minimale të likuiditetit të detyrueshëm, Mbështetje për kompanitë e sigurimeve për diversifikim të gamës së shërbimeve siguruese.</p>	<p>BQK, bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve, shoqatat e bankave dhe të kompanive të sigurimeve.</p> <p>Ndryshimet e rregullativës së BQK-së</p>
<p>Masa mbështetëse për ekonomi nga sektori financiar</p>	<p>Mobilizimi i 1.2 miliard eurove për mbështetje ekonomike për 2020 dhe 2021: 180 milionë euro kurseme nga buxheti i vitit 2020, 51.6 milionë nga FMN-ja, 100 milionë nga Komisioni Evropian, 120 milionë nga Banka Botërore, 60 milionë nga mjetet e privatizimit, 100 milionë nga emetimi i letrave me vlerë, 200 milionë nga emetimi i letrave me vlerë nga diaspora, 300 milionë euro kredi ndërkombëtare për financim të projekteve kapitale të ndërmarrjeve publike, komunave dhe të nivelit qendror, 100 milionë euro garanci kreditore për projekte investive prodhuese, 170 milionë euro kthime të kurseimeve pensionale për kontribut</p>	<p>Rishikimi i buxhetit të vitit 2020, Mobilizimi i mjeteve nga borxhi i brendshëm përmes letrave me vlerë dhe borxhi i jashtëm përmes kredive nga institucionet financiare ndërkombëtare, Përgatitja e Strategjisë së borxhit publik për një periudhë afatgjatë, për të siguruar financim adekuat dhe qëndrueshmëri fiskale.</p> <p>Qeveria, Kuvendi, komunat, donatorët, bankat zhvillimore ndërkombëtare, diaspora.</p>
<p>Mobilizimi për financimin e masave</p>	<p>Mobilizimi i fondeve për financim të masave për rimëkëmbje ekonomike, përmes: buxhetit, duke rishikuar projektionet buxhetore, deficitin buxhetor dhe borxhin publik; financimit nga donatorët; nga borxhi publik i brendshëm nga letrat me vlerë dhe kreditë e jashtme; financimit të projekteve përmes partneritetit publiko-privat, etj.</p>	<p>Qeveria, Kuvendi, komunat, donatorët, bankat zhvillimore ndërkombëtare, diaspora.</p>

Masat e parapara për rimëkëmbje ekonomike do të realizohen në bashkëpunim të ngushtë me:

Asociacionet e biznesit, si në identifikim të problemeve, ashtu edhe në zbatimin e masave nëpër sektorë të caktuar, duke marrë parasysh specifikat e sektorëve,

Komunat, në veçanti në realizimin e masave në sektorin e bujqësisë, duke i targetuar regjionet dhe lokalitetet më të prekura,

Bankën Qendrore të Kosovës, për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit financiar, rritur potencialin kreditor të bankave dhe diversifikuar rrezikun nga kredidhënia,

Institucionet ndërkombëtare, siç janë FMN-ja, Banka Botërore, Komisioni Evropian, si dhe organizatat e tjera që operojnë në Kosovë (UNDP, USAID, GIZ, etj.), për krijimin e singergjisë nga ky bashkëpunim dhe për absorbimin sa më efikas të asistencës teknike dhe financiare,

Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, përfaqësuesit e vendeve të QUINT-it, si dhe përfaqësuesit e tjerë diplomatikë në Kosovë,

Shoqërinë civile dhe mediat, si partnerë shumë të rëndësishëm për ofrimin e ekspertizës së nevojshme dhe për informimin e qytetarëve.

REFERENCAT

- Anderson, J. et al. (2020). Rebooting Europe: A Framework for a Post COVID-19 Economic Recovery. Policy Brief. Issue 1, maj 2020. Bruegel. Bruksel, Belgjikë.
- Banka Botërore (2020). The Economic and Social Impact of COVID-19: Health Systems. Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor. Raporti Nr.17, Pranverë 2020.
- Banka Qendrore e Kosovës (2020). Buletini mujor statistikor Nr. 222 - 224.
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (2020). Crisis Like No Other, An Uncertain Recovery: World Economic Outlook, qershor 2020.
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (2020). Raporti No. 20/112, Republika e Kosovës.
- Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (2020), "Eastern Europe Coronavirus tracker: Preparing for the worst", 31 mars. Artikulli i disponueshëm në: <https://wiiw.ac.at/n-430.html> (qasur më 1 qershor 2020).
- Instituti Riinvest (2020). Implikimet ekonomike e sociale të Covid -19, Kosova dhe Ballkani Perëndimor, qershor 2020
- Instituti Riinvest (2020). Pakoja Fiskale Emergjente, implikimet dhe sfidat e zbatimit, qershor 2020
- Instituti Riinvest (2020). Skenarët lidhur me Covid -19 dhe rimëkëmbja shëndetësore e ekonomike në Kosovë, korrik 2020.
- Joseph E. Stiglitz (2020), "Internationalizing the Crisis", Project Syndicate, 6 prill 2020. Artikulli i disponueshëm në: <https://www.project-syndicate.org/commentary/covid19-impact-on-developing-emerging-economies-by-joseph-e-stiglitz-2020-04?barrier=accesspaylog> (qasur më 30 maj 2020)
- McKinsey & Company (2020). Covid -19, Briefing Material, Global Health Crises Response, prill 2020.
- Ministria e Financave dhe Transfereve të Republikës së Kosovës (2020). Korniza makro-fiskale 2020-2022.
- Programi i Qeverisë së Kosovës, qershor 2020.
- Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020
- The Balkans in Europe Policy Advisory Group (2020). Western Balkans in Times of Global Pandemic.

